

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6041
E premte, 19 qershor 2020
çmimi 0.40 €

Rreth 120 punëtorë shëndetësorë të infektuar me Covid-19

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KOSOVA BËN PËRGATITJET PËR TAKIMIN E PARALAJMËRUAR NË SHTËPINË E BARDHË MË 27 QERSHOR

FAQE 4-5

Bëhet thirrje për unitet të spektrit politik për takimin në Uashington

Presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Avdullah Hoti kanë bërë me dije se janë të përgatitur për takimin e paralajmëruar më 27 qershor në Uashington për rifillimin e dialogut me Serbinë. Kryeministri Hoti të enjten ka mbajtur takimin e parë formal të forumit të liderëve të partive politike, ku ka bërë thirrje për unitet të spektrit politik në këtë proces, kurse ka paralajmëruar se javën e ardhshme do të raportojë në Kuvend për këtë proces. Këtë takim të tij e kanë bojkotuar LV-ja dhe PDK-ja, ndërkaq presidenti Hashim Thaçi, në një konferencë për media, takimin në Shtëpinë e Bardhë e ka quajtur kthesë historike, duke theksuar se në këtë takim Kosova do të flasë me një zë. Profesorët e marrëdhënieve ndërkombëtare e kanë ftuar spektrin politik që të tregojë unitet dhe përgjegjshmëri në këtë proces



OPINION

PSE DUHET TË SHKOHET NË UASHINGTON, EDHE PSE MARRËVESHJA DUKET E LARGËT? F. 8

Shkruan: Prof Ibrahim GASHI



AKTUALE

ALBIN BYTYÇI, KADETI I PARË I PËRZGJEDHUR PËR TË STUDIUAR NË AKADEMINË E FORCAVE AJRORE NË SHBA F. 6

UKZ-ja MERR KRYESIMIN E RADHËS SË KONFERENCËS SË REKTORËVE F. 7

EKONOMI

MTI-ja MERR VENDIM TË RI PËR BIZNESET E GASTRONOMISË F. 9

REFORMA E DREJTËSISË KOMERCIALE, PARAKUSHT PËR TËRHEQJEN E INVESTIMEVE TË HUAJA F. 9



SPORT

SELIMI, TRAJNERI MË I RI QË FITOI TROFE: ISHIN NDJENJA TË PAPËRSHKRUESHME. NUK I HARROJ KURRË F. 13

VESELI: QEVERITË E MASHTRIMIT PO BIEN NJËRA PAS TJETRËS



Kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, ka thënë të enjten se partia që drejton gjithmonë do ta ruajë partneritetin me miqtë tanë ndërkombëtarë,

posaçërisht me ShBA-në. Ai ka thënë se qeveritë e mashtrimit po bien njëra pas tjetrës, duke paralajmëruar rikthimin e PDK-së në pushtet. "Shpejt në Kosovën tonë, me besimin e juaj të dashur

qytetarë, do të kemi një qeveri e cila do të udhëhiqet nga PDK-ja për t'i ruajtur vlerat e lirisë, amanetin e heronjve, jetën e vlefshme dhe respektin për njëri-tjetrin", është shprehur Veseli

FAQE 3

SHTYHET TESTI I ARRITSHMËRISË DHE TESTIT TË MATURËS SHTETËRORE

FAQE 6



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjiibiznesi.com
info@kolegjiibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Pse duhet të shkohet në Uashington, edhe pse marrëveshja duket e largët?



Shkruan: Prof. Ibrahim GASHI

Procesi i dialogut midis Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësimin e BE-së për, pothuajse një dekadë, ka shpërfaqur në mënyrë graduale kompleksitetin dhe ndërlikueshmërinë e tij të skajshme. Progresi dhe marrëveshjet e arritura në fillim janë dukur si një dritë në fund të tunelit dhe kanë rritur pritjet, sidomos në Prishtinë, se gjërat po lëvizin shpejt, se veriu po integrohet dhe se marrëdhëniet me Serbinë po normalizohen. Barrierat që ka nxjerrë në vijimësi Beogradi për zbatimin e marrëveshjeve të nënshkruara, gjuha e ashpër e zyrtarëve më të lartë, e stilit se “kurrë nuk do ta njohim

Kosovën”, përfshirja në preambulën e Kushtetutës së shtetit serb të Kosovës si pjesë e saj, sidomos fushata lobuese kundër njohjeve të shtetit Kosovës, janë treguesit më kokëfortë se palët kanë pozicione aq të largëta dhe aq të ngurta saqë as edhe një shëkull nuk do mund të merren vesh pa një gjuhë të fortë ndërmjetësimi, që nënkupton ndërhyrje të drejtpërdrejta nga një fuqi botërore absolute, e cila do t'i dëgjonte palët dhe vetë do ta thoshte fjalën e fundit.

Nëse me këtë optikë reale i shohim gjerat ne këtu në Prishtinë dhe vetëm pak i kthehemi kujtesës jo të largët historike, atëherë zërat kundërshtues, hezitues dhe ekuivokët politikë, të shkohet a të mos shkohet në Uashington, janë jo vetëm të gabuar, por edhe të dëmshëm.

Zyrtarët më të lartë të shtetit të Kosovës, në formatin siç janë ftuar, duhet të shkojnë në Uashington, të tregojnë seriozitet dhe konstruktivitet në dialog, që nënkupton t'i mbrojnë qëndrimet tashmë të deklaruar nga ana e tyre, se

s'ka ndryshim kufijsh, se s'ka ndarje, se s'ka kompetenca të reja jokushtetuese për asociacionin dhe se njohja reciproke duhet të jetë veredikti final i këtij dialogu.

Tani përse Uashingtoni dhe Shtëpia e Bardhë duhet të jetë vendi i bisedimeve?

Së pari konsistenca dhe koherenca e mbështetjes së politikës dhe diplomacisë amerikane për shtetësinë e Kosovës, që nga faza e para shpalljes së saj, gjatë aktit të shpalljes dhe veçmas në periudhën e pas shpalljes, përmes procesit të lobimit dhe sjelljeve të njohjeve të numërta dhe për më shumë lobimi i fuqishëm dhe asistencë profesionale me ekspertizë juridike për ta argumentuar të drejtën e Kosovës në aktin e saj të shpalljes së pavarësisë, pranë GjND-së, janë vetëm disa pikarritje kulmore që provojnë qëndrimin konstruktiv dhe mbështetës të Uashingtonit zyrtar ndaj shtetit të Kosovës, në gjithë trajektoren kohore të tij.

Së dyti, në teorinë e negociimit, përcaktimi i palës ndërmjetëse dhe vendi i bisedimeve janë

faktorë që, në masë të konsiderueshme, e determinojnë suksesin për arritjen e marrëveshjeve në një proces të vështirë dialogu. Teoricienët konsiderojnë se ndërmjetësit kryesorë janë shtetet e fuqishme të cilat mund të veprojnë vetëm ose në mënyrë kolektive apo edhe nëpërmjet organizatave ndërkombëtare, ku kanë ndikim të fuqishëm. E para dhe më kryesorja, shtetet e veshin mantelin e ndërmjetësimi për t'i shuar krizat të cilat kërcënojnë stabilitetin politik dhe ekonomik për të cilin ato kanë interes të veçantë. ShBA-ja padyshim vazhdon të jetë e interesuar për stabilitetin politik dhe ekonomik si dhe për sigurinë e Ballkanit edhe kuadri i gjeopolitikës së tyre evropiane. Kosova në këtë mes ka një rëndësi parësore për aq kohë sa raporti midis i saj me Serbinë është i tendosur dhe jo normal. Së këndejmi Kosova duhet parë bisedimet në Uashington si mundësi reale, mbase të vetmen, për arritjen e një marrëveshjeje të favorshme.

Së fundi Brukseli, sikurse edhe

Prishtina, duhet ta shohin me dashamirësi dhe optimizëm aktivizimin e Uashingtonit në pjesën më të vështirë dhe më të rëndësishme të procesit, atë të arritjes së një marrëveshjeje përfundimtare. Madje Brukseli pa asnjë hezitim duhet t'i bashkohet Uashingtonit dhe bashkohet kurorëzojnë procesin me një marrëveshje finale. Sa i takon marrëveshjes eventuale, konsideroj se pozicionet janë shumë të largëta dhe, për rrjedhojë, edhe arritja e një marrëveshjeje eventuale duket e largët. Edhe sikur palët dhe ndërmjetësit të arrijnë në parim pajtueshmëri për ndonjë draft fillestar, sërish është iluzore për të pritur marrëveshje finale në një kohë të shkurtër. Megjithatë, duke njohur stilin e ndërmjetësve amerikanë, të cilët kanë kurajën për t'u shkuar gjërave deri në fund, pa prognozuar afate kohore, fundi i ditës do të sjellë një marrëveshje të pranueshme për palët, ngaqë çdo epilog tjetër do të ishte mossukses i palëve ndërmjetëse, para së gjithash ShBA-së, me të cilin vështirë se do të pajtoheshin.

Ministrja Haradinaj-Stublla, Lajçakut: Kosova i përket Evropës



PRISHTINË, 18 QERSHOR (ER) - “Kosova, historikisht dhe gjeografikisht i përket Evropës dhe është e vendosur që të zë vendin e vet të merituar në strukturat e Bashkimit Evropian”, ka thënë ministrja e Punëve të Jashtme e

Kosovës, Meliza Haradinaj-Stublla, pas takimit që ka pasur të enjten me të dërguarin special të BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak. Ajo ka thënë se takimi i sotëm me Lajçakun shërbeu për ta shprehur

qartazi indinjatën e Kosovës me padrejtësinë dhe vonesat e tejzgjatura për agjendën e liberalizimi të vizave, të drejtë të cilën Kosova e ka fituar me përbushjen e të gjitha kriterëve. “Po ashtu, shpalosa qëndrimin unik të Kosovës

për gatishmërinë e arritjes së një marrëveshjeje përfundimtare me Serbinë për njohje reciproke në kufijtë ekzistues dhe në koordinim të plotë me ShBA-në dhe me ndihmën e Bashkimit Evropian. Gjithashtu, shpreha

nevojën që edhe BE-ja të punojë në një dinamikë të re, që ta shtyjë përpara njohjen e Republikës së Kosovës edhe nga pesë vendet anëtare të BE-së që ende nuk e kanë njohur Kosovën”, ka thënë ministrja Haradinaj-Stublla.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka mbajtur mbledhjen e Kryesisë në Skenderaj

Veseli: Qeveritë e mashtrimit po bien njëra pas tjetrës

Kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, ka thënë të enjten se partia që drejton gjithmonë do ta ruajë partneritetin me miqtë tanë ndërkombëtarë, posaçërisht me ShBA-në. Ai ka thënë se qeveritë e mashtrimit po bien njëra pas tjetrës, duke paralajmëruar rikthimin e PDK-së në pushtet. “Shpejt në Kosovën tonë, me besimin e juaj të dashur qytetarë, do të kemi një qeveri e cila do të udhëhiqet nga PDK-ja për t’i ruajtur vlerat e lirisë, amanetin e heronjve, jetën e vlefshme dhe respektin për njëri-tjetrin”, është shprehur Veseli

koncepti modern ekonomik në parimin djathtist të tregut dhe konkurrencës së lirë, ndryshimit të mençur, në të cilin shtet përbrenda lartësohen dhe përparojnë vlerat tona kombëtare”, ka thënë ai.

Veseli ka shtuar se akti i çlirimit dhe pavarësisë nuk është i vetëmjaftueshëm e nuk mbahet gjallë vetëm me fjalë të zbrazëta. “Nuk mbahet me ideologji të çoroditura, me flamuj që mbahen lart në kohë fushate dhe gjuhën e ndarjes dhe urrejtjes kur të merret pushteti. Ne kemi synim të qartë që ta mbrojmë shtetin tonë me çdo kusht dhe të përpiqemi për të siguruar dhe garantuar të drejtat e shqiptarëve kudo që ata janë. Sepse e kemi bërë këtë shtet edhe kur nuk ka ekzistuar; kemi luftuar për të, jemi gjakosur edhe kur disa me të drejtë janë frikësuar; nuk e kemi ndërmend ta falim, por as ta lëmë ta nëpërkëmbë askush. Nuk kemi tokë për të dhënë, nuk kemi shtet për të mohuar. Kjo është shtëpia jonë e sigurt, jeta jonë dhe e ardhmja e fëmijëve tanë”, ka deklaruar Veseli.

Ai ka pohuar se koncepti i tyre politik bazohet në idetë e reja dhe të domosdoshme. “Në përkushtimin e secilit për ta përfunduar shtetndërtimin tonë me një qeverisje të PDK-së, e cila

do të arrijë ta shndërrojë vendin tonë në një vend ku jeta e secilit qytetar do të jetë e kënaqshme për secilin, në të drejta dhe përgjegjësi.

Rimëkëmbja ekonomike është vizioni ynë më i qartë dhe përkushtimi ynë kryesor”, është shprehur ai, duke theksuar se “ndërmarrësit e shkathët po na rrezikohen nga pamundësia të punojnë, mijëra familje po rrezikohen të mbesin pa të ardhurat e tyre mujore. Qeveritë që po ndërrohen për teke dhe mashtrime nuk guxojnë të sillen sikur asgjë s’ka ndodhur. Nuk guxojnë ta lënë sektorin tonë privat, ndërmarrësit dhe punonjësit nën mëshirën e fatit, por duhet të angazhohen me veprime konkrete që t’ua kthejnë besimin, për ta vazhduar rritjen ekonomike në vendin tonë”, ka deklaruar kryetari i PDK-së.

Veseli ka paralajmëruar se PDK-ja nga dita e premte do t’i iniciojë nismat legislative të cilat do t’i shërbejnë shtetit të Kosovës. “Do ta trajtojmë secilin shqetësim të qytetarëve tanë, që nga paslufta e deri më sot. Këtë jua garantoj këtu. Disa parti po përpiqen me fjalë, urrejtje, mospunë dhe mashtrime t’i pushtojnë mendjet e qytetarëve. E kanë bërë ideal, kauzë për të fituar për vete, luftën brenda shqiptarëve, mu në kohën e një ballafaqimi jo të lehtë në përmbylljen e

pakompromis të shtetësisë sonë me Serbinë dhe anëtarësimin në OKB. Kjo nuk është duke u bërë pa qëllim. Kjo nuk e ndihmon Kosovën përballë Serbisë. Kjo e rrezikon Kosovën. Jam i lumtur që qytetarët po i kuptojnë këto kurthe dhe po i demaskojnë çdo ditë ato. Nuk ka kompromis me mashtrues. Nuk ka besim në ata që nuk mbajnë asnjë fjalë dhe i ndryshojnë në bazë të interesit dhe zorit. Kjo është arsyeja që qeveritë e mashtrimit po bien njëra pas tjetrës dhe as që do të mund të qëndrojnë. Qytetari ynë është shumë i mençur dhe i dallon këto kurthe”, ka thënë ai, duke shtuar se përkushtimi i PDK-së do të jetë edhe për një partneritet të qëndrueshëm me miqtë tanë ndërkombëtarë, posaçërisht me ShBA-në ku, sipas tij, qeveria e shkuar i dëmtoi skajshmërisht raportet, duke e rrezikuar edhe qenien shqiptare në Ballkan. “Prandaj, shpejt në Kosovën tonë, me besimin e juaj të dashur qytetarë, do të kemi një qeveri e cila do të udhëhiqet nga PDK-ja për t’i ruajtur vlerat e lirisë, amanetin e heronjve, jetën e vlefshme dhe respektin për njëri-tjetrin, Skenderajn dhe Kosovën e zhvilluar, fuqinë e koalicionit të pandarë me ShBA-në dhe integrimin në NATO dhe BE”, ka thënë Veseli.

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

SKENDERAJ, 18 QERSHOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka mbledhur të enjten kryesinë qendrore të kësaj partie në qytetin e Skenderajt, për nder të Ditës së Çlirimit të vendlindjes së komandantit legjendar të UÇK-së, Adem Jashari, me ç’rast ka shpalosur vizionin e ri të partisë për të tashmen dhe të ardhmen e vendit.

Lideri i PDK-së ka thënë se në kohë globale pandemie partitë që mashtruan qytetarët në zgjedhjet e fundit i harruan qytetarët dhe ndërmarrësit dhe u morën me teket dhe interesat personale për pushtet. “Disa parti po mundohen me fjalë, urrejtje, mospunë dhe mashtrime t’i pushtojnë mendjet e qytetarëve. E kanë bërë ideal, kauzë për të fituar për vete, luftën brenda shqiptarëve, mu në kohën e një ballafaqimi jo të lehtë për përmbylljen e pakompromis të shtetësisë sonë me Serbinë dhe anëtarësimin në OKB. Kjo nuk është duke u bërë pa qëllim. Kjo nuk e ndihmon Kosovën përballë Serbisë. Kjo e rrezikon Kosovën”, ka thënë Veseli.

Ai ka theksuar se qytetarët po i kuptojnë këto kurthe të partive që i mashtruan dhe po i demaskojnë çdo ditë ato. “Nuk ka kompromis me mashtrues, nuk ka besim në ata që nuk mbajnë asnjë fjalë dhe i ndryshojnë në bazë të interesit dhe zorit. Kjo është arsyeja që qeveritë e mashtrimit po bien njëra pas tjetrës dhe as që do të mund të qëndrojnë. Qytetari ynë është shumë i mençur dhe i dallon këto kurthe. Duhet punë, vizion, guxim, vendosmëri dhe përgjegjësi për ta çuar përpara amanetin e tribunëve të kombit tonë. Si PDK, jemi të përkushtuar për të sotmen dhe të ardhmen dhe vetëm për të.

Por, edhe mund të flasim për secilën punë dhe ngjarje edhe të së djeshmes”, ka thënë Veseli.

Duke folur për Ditën e Çlirimit të Skenderajt, lideri i PDK-së ka theksuar se do të jetë përkushtim i vazhdueshëm për t’i nderuar të rënë tanë në luftën çlirimtare. “Shënimi i Ditës së Çlirimit në Skenderaj është përkushtimi ynë i vazhdueshëm për t’i nderuar të rënë tanë në luftën çlirimtare dhe betimi ynë për një të ardhme më të mirë për brezat që po vijnë. Në Prizren e kemi filluar rrugëtimin tonë për rimëkëmbje kombëtare, një koncept të ri politik në të cilin do të zënë vend shteti i së drejtës,



KOSOVA BËN PËRGATITJET PËR TAKIMIN E PARALAJMËRUAR NË SHTËPINË E BARDHË MË 27 QERSHOR

BËHET THIRRJE PËR UNITET TË SPEKTRIT



Presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Avdullah Hoti kanë bërë me dije se janë të përgatitur për takimin e paralajmëruar më 27 qershor në Uashington për rifillimin e dialogut me Serbinë. Kryeministri Hoti të enjten ka mbajtur takimin e parë formal të forumit të liderëve të partive politike, ku ka bërë thirrje për unitet të spektrit politik në këtë proces, kurse ka paralajmëruar se javën e ardhshme do të raportojë në Kuvend për këtë proces. Këtë takim të tij e kanë bojkotuar LV-ja dhe PDK-ja, ndërkaq presidenti Hashim Thaçi, në një konferencë për media, takimin në Shtëpinë e Bardhë e ka quajtur kthesë historike, duke theksuar se në këtë takim Kosova do të flasë me një zë. Profesorët e marrëdhënieve ndërkombëtare e kanë ftuar spektrin politik që të tregojë unitet dhe përgjegjshmëri në këtë proces

nga qeveria në Prishtinë dhe në Beograd, se do t'i përgjigjen ftesës për një takim në Uashington më 27 qershor. Këtë takim nuk ka dashur ta komentojë edhe përfaqësuesi i BE-së, Miroslav Lajçak, i cili që disa ditë po qëndron në Prishtinë. "Nuk jam këtu që të zgjedh partner. Respektoj faktin që qeveria do t'i udhëheqë negociatat. Për ne ShBA-ja është një partnere shumë e suksesshme. Ne kemi qenë shumë të suksesshëm kur kemi punuar në tandem, sidomos në Ballkan. Ne komunikojmë me partnerët tanë në ShBA për iniciativat tona. Pres që edhe ata ta bëjnë të njëjtën gjë", ka thënë ai në një konferencë për media në Prishtinë.

Lajçak ka theksuar se asnjë marrëveshje e mirë nuk mund të arrihet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë pa praninë e Bashkimit Evropian. "Unë mendoj se kam qenë i qartë për rëndësinë e dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja.

Gjithashtu, dua të them se Shtetet e Bashkuara janë një partner i rëndësishëm për ne dhe se historia ka dëshmuar se ne kemi qenë gjithmonë të suksesshëm kur kemi punuar së bashku e në të njëjtën kohë. Kosova është në Evropë dhe askush tjetër nuk mund t'i japë një të ardhme evropiane Kosovës përveç BE-së. Një marrëveshje e mirë është marrëveshja që i sjell Kosovën dhe Serbinë më afër Bashkimit Evropian dhe nuk mendoj se një marrëveshje e tillë mund të arrihet pa praninë e BE-së", ka thënë Lajçaku.

Ai nuk ka dhënë asnjë datë se kur mund të rifillojë dialogu i ndërmjetësuar nga BE-ja, duke shtuar se data do të jetë publike, pas takimit me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq. "Jam i kënaqur që dialogu i lehtësuar nga BE-ja është prioritet për qeverinë. Pres që dialogu të fillojë së shpejti. Javën e ardhshme do ta vizitoj Beogradin dhe do të flas me

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË 18 QERSHOR - Përfaqësuesit specialë të ShBA-së dhe të BE-së për dialogun Kosovë - Serbi janë shprehur të gatshëm për fillimin e këtij procesi. Derisa i dërguari i posaçëm i BE-së, Miroslav Lajçak, po konsultohet me palët, emisari i presidentit amerikan Donald

Trump, Richard Grenell, u ka bërë thirrje palave që i ka ftuar për takim më 27 qershor në Uashington, që ta shfrytëzojnë këtë rast historik për të arritur një marrëveshje.

Ai ka vlerësuar se mundësia e Shtëpisë së Bardhë i hapë dyert zhvillimit ekonomik dhe investimeve. "Kjo mundësi e Shtëpisë së Bardhë i hapë dyert zhvillimit ekonomik dhe investimeve. Shtetet e

Bashkuara të Amerikës shpresojnë se liderët në Kosovë dhe Serbi do ta shfrytëzojnë këtë shans për t'u rikthyer në dialog dhe për të filluar një epokë të re të stabilitetit dhe prosperitetit. Njerëzit e këtij rajoni nuk meritojnë asgjë më pak", është cituar të ketë thënë Grenell, sipas Ambasadës Amerikane në Prishtinë.

Grenelli ka marrë konfirmimin

POLITIK PËR TAKIMIN NË UASHINGTON

duhet t'i zgjidhë të gjitha çështjet e hapura.

Thaçi: Nga Uashingtoni gjithmonë kanë ardhur lajme të mira

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, e ka cilësuar kthesë historike takimin me palën serbe më 27 qershor në Shtëpinë e Bardhë. Në një konferencë për media, Thaçi ka pohuar se qytetarët e Kosovës gjithmonë kanë marrë lajme të mira nga Uashingtoni. "Takimin e paralajmëruar në Shtëpinë e Bardhë e konsiderojmë kthesë historike dhe mundësi të papërsëritshme për fillimin e një procesi tepër të vështirë, shumë të rëndë, por të domosdoshëm për arritjen e paqes. Qytetarët e Kosovës e dinë shumë mirë se nga Uashingtoni gjithmonë kanë ardhur lajme të mira. Kështu do të jetë edhe sot, por edhe në të ardhmen. Kam besim të plotë, se edhe takimi në Uashington do t'i kontribuojë konsolidimit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar të shtetit të Kosovës", ka deklaruar Thaçi.

Ai ka thënë se Kosova në këtë takim, që është thirrur nga i dërguari i Shtëpisë së Bardhë për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, Kosova shkon e përgatitur dhe se ai dhe kryeministri Avdullah Hoti në këtë takim do të kenë qëndrime të koordinuara. "Ne do të flasim me një zë. Do ta respektojmë vullnetin e qytetarëve të Kosovës. Do të kemi një koordinim ndërinstitucional. Konsultat janë duke vazhduar. Kosova ka bartësit e institucioneve të shtetit, përfaqësuesit legjitimë në hierarkinë institucionale. Por, për ta shuar kureshtjen tuaj, dëshiroj të potencoj se përgjegjësitë janë të qarta në përputhshmëri me Kushtetutën e Kosovës", është

shprehur presidenti Thaçi, duke shtuar se Kosova po punon për arritjen e një marrëveshjeje paqësore, që t'i jepte fund konfliktit me Serbinë dhe do t'i hapte rrugë anëtarësimit të Kosovës në mekanizmat ndërkombëtarë. Duke komentuar deklaratat e të dërguarit të posaçëm të Bashkimit Evropian për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, i cili ka theksuar se askush nuk mund t'i ofrojë të ardhme evropiane Kosovës, pos BE-së dhe se blloku evropian nuk mund të lihet anash nga procesi i bisedimeve, presidenti Thaçi tha se "Bashkimi Evropian hyn në këtë proces me një të metë shumë të madhe". "Hyn me hendikepin e mosliberalizimit të vizave për Kosovën, gjë që e rritë mosbesimin, por edhe dëshpërimin e njerëzve në Kosovë për misionin dhe përkushtimin e tyre aktual. Sido që të jetë, ne do të punojmë ngushtë që të kemi sukses edhe në samitin e Parisit që do të mbahet në javën e tretë të muajit korrik", ka deklaruar Thaçi.

Ai ka theksuar se BE-ja dhe i dërguari i posaçëm Lajçak "duhet të jenë të fokusuar më tepër në substancën që ai mendon të prezantojnë dhe më pak të jenë të shqetësuar për rezultatet e takimit në Uashington".

Hoti mban takimin e parë formal të liderëve, nuk shkojnë LV-ja e PDK-ja

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka mbajtur të enjten takimin e parë formal të forumit të liderëve të partive politike në të cilin nuk kanë marrë pjesë dy partitë opozitare, LV-ja dhe PDK-ja. Pas takimit, ai ka falënderuar liderët e partive politike që ishin pjesë e këtij takimi. "Të gjithë pa përjashtim i dhanë mbështetje qasjes që kemi si

qeveri, parimeve që kemi vendosur për procesin e dialogut dhe transparencën që do të sigurojmë gjatë gjithë kohës në këtë proces", ka thënë Hoti.

Ai sërish ka shprehur gatishmërinë e tij politike për t'u takuar me subjektet opozitare. "Edhe nga kjo paraqitje unë ftoj partitë opozitare që të marrin rolin e tyre mbikëqyrës në procesin e dialogut përmes forumit të liderëve të partive politike dhe pastaj në Kuvend përmes Komisionit Parlamentar për dialog. Dje unë u kam dërguar ftesa të gjithë liderëve të partive politike. Unë do t'u qasem atyre edhe në ditët e ardhshme, kudo që ata e shohin të nevojshme që të takohemi në zyrën time, në Kuvend apo në zyrat e tyre të partive politike", ka thënë ai.

Hoti ka paralajmëruar se javën e ardhshme do të raportojë në Kuvend për takimin që do të mbahet më 27 qershor në Uashington. Kryeministri ka shprehur optimizëm për këtë takim. "Agjenda e Uashingtonit besoj se do të bëhet e qartë përpara se të shkojmë atje. Pritjet janë shumë pozitive. Ne shkojmë për ta filluar procesin e dialogut që çon në njohje reciproke. Kjo është e rëndësishme", ka thënë Hoti.

Në këtë takim me kryeministrin kanë marrë pjesë kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj dhe kreu i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, përfaqësues të Aleancës Kosova e Re dhe anëtarë të partive të komuniteteve joshumicë.

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, pas takimit të Forumit të Liderëve të Partive Parlamentare, ka thënë se ky forum është mundësi e mirë për bashkërendim të aktiviteteve në procesin dialogues me Serbinë. "Në takimin e parë të këtij formati

theksova rëndësinë që ka për vendin krijimi i një konsensusi sa më të gjerë për këtë temë. Në këtë frymë, bëj thirrje që pjesë e këtij forumi të jenë edhe partitë e tjera opozitare. Është jetike për vendin që të gjithë të jemi bashkë në këtë proces, pozitë dhe opozitë. Dy gjëra duhen qartësuar para fillimit të dialogut: kohëzgjatja dhe emërtimi. Procesi i ardhshëm dialogues me Serbinë, kudo që zhvillohet, duhet të ketë emër: dialog për njohje. Si dhe është shumë me rëndësi që dialogu të përshkruhet me transparencë të plotë", ka deklaruar lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj.

Në këtë takim nuk kanë qenë as përfaqësuesit e Listës Serbe, por kryeministri Hoti ka thënë se ka pasur takime individuale me të gjithë liderët e partive politike parlamentare për platformën e qeverisë.

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Afrim Hoti, ka ftuar spektrin politik të Kosovës që të tregojë unitet dhe përgjegjshmëri në këtë proces. "Mendoj se është momenti i fundit që të gjithë të tregojnë përgjegjshmëri në këtë proces. Nuk është çështje e zgjedhjes së tyre, por çështje e obligimit kombëtar për ta përmbyllur këtë proces. E kundërta do të na ballafaqonte me situata të pakëndshme dhe me atë që ne e njohim si kompromis të vazhdueshëm", ka thënë Hoti për "Epokën e re".

Dialogu politikë Kosovë - Serbi, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, nisi më 2011. Në fund të vitit 2018 ky proces u ndërpre për shkak të një takse të vendosur nga Qeveria e Kosovës ndaj mallrave të Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës. Taksa u zëvendësua me masat e reciprocitetit, por më 6 qershor qeveria e Avdullah Hotit hoqi reciprocitetin, me qëllim që të hiqen të gjitha pengesat për dialog.

presidentin Vuçiq që të pajtohem dhe do të publikojmë një datë për rifillimin e dialogut. Duam të lehtësojmë një marrëveshje gjithëpërfshirëse për normalizim të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Mandati im është normalizimi i marrëdhënieve mes dy vendeve", është shprehur Lajçaku. Sipas tij, një marrëveshje eventuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

Hoti me ambasadorët e BE-së: Karakteri unitar i Kosovës është i panegociueshëm

PRISHTINË, 18 QERSHOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur të enjten në takim ambasadorët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian në vendin tonë. Me këtë rast, kryeministri Hoti i ka falënderuar ambasadorët e Bashkimit Evropian për mbështetjen që i kanë dhënë Kosovës vendet e BE-së për menaxhimin e pandemisë Covid-19 si dhe i ka njoftuar ata

për masat që po i ndërmerr Qeveria e Kosovës për rimëkëmbjen ekonomike nga pasojat e shkaktuara si pasojë e kësaj pandemie.

Po ashtu, kryeministri Hoti ka shpalosur platformën e Qeverisë së Kosovës për dialogun me Serbinë. Ai ka theksuar se parimet mbi të cilat do ta vendosin këtë proces janë integriteti territorial i Kosovës që, siç ka thënë ai, është i

panegociueshëm, karakteri unitar i shtetit të Kosovës, ndërsa marrëveshja duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Hoti ka thënë se Qeveria e Kosovës e ka strukturuar qasjen në këtë proces të dialogut duke e formalizuar mënyrën se si duhet të zhvillohet ai, por që objektiv kryesor në gjithë këtë proces është njohja reciproke në mes dy vendeve.



Albin Bytyçi, kadeti i parë i përzgjedhur për të studiuar në Akademinë e Forcave Ajrore në ShBA

PRISHTINË, 18 QERSHOR (ER) - Kadeti i parë nga Kosova, i përzgjedhur për të studiuar në Akademinë e Forcave Ajrore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Albin Bytyçi, është duke bërë përgatitjet e fundit fizike para nisjes për në Colorado Springs të ShBA-së, ku do të jetë pjesë e gjeneratës 2024 të kësaj akademie. Arianit Bytyçi në llogarinë e vet në "Facebook" ka publikuar disa fotografi në të cilat shihet përkrah xhaxhait të vet, gazetarit të njohur të luftës, Nuhi Bytyçi, në parkun e Gërmisë në Prishtinë. "Bashkë me babanë iu bashkuam iniciativës së Albinit për të ecur e vrapuar

stazës së gjatë dhe magjepsëse të Gërmisë. Albini gjithmonë ka iniciativa të mira. Të gjithë jemi krenarë me edukatën dhe formimin e Albinit tonë, edhe me sukseset e tij të posaçme të nivelit ndërkombëtar, përmes të cilave në një të ardhme të afërt ai do t'i shërbejë zhvillimit të vendit", ka shkruar arkitekti Arianit Bytyçi, i biri i gazetarit Nuhi Bytyçi.

Sipas një njoftimi zyrtar për media të para disa javëve, Forca e Sigurisë së Kosovës që nga themelimi i saj për herë të parë do të dërgojë kadetë për t'u shkolluar në Akademinë e Forcave Ajrore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Kadeti i përzgjedhur është Albin Bytyçi. "Të gjitha testimet si dhe nominimet e kandidatëve janë bërë në kuadër të bashkëpunimit në mes të Ambasadës Amerikane në Kosovë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Kandidatët u janë nënshtruar testeve rigorozë, duke filluar nga testi i inteligjencës, testi i gjuhës angleze ECL, testi SAT si dhe testi fizik. Kadeti Albin Bytyçi ka qenë kandidati i cili, në bazë të performancës së testeve dhe kriterëve të tjera të përcaktuara, është përzgjedhur nga Akademia e Forcave Ajrore të ShBA-së për shkollim në kuadër të gjeneratës 2024", kishte njoftuar FSK-ja.



Vihet gurthemeli i kullës Basri Canolli në përvjetorin e rënies së heroit të Gollakut



PRISHTINË, 18 QERSHOR (ER) - Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka marrë pjesë përvjetorin e rënies së heroit të Gollakut, Basri Canolli, ku edhe është bërë vënia e gurthemelit të ndërtimit të Kullës së heroit Basri (Halli) Canolli-Shpendi, në fshatin Marec, investim i MKRS-së, objekt i trashëgimisë i cili do ta mbajë emrin e tij. Në këtë ceremoni morën pjesë edhe ish-kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ish-deputetë të zonës dhe bashkëluftëtarë të heroit Canolli. Me këtë rast, ministrja

Dumoshi ka thënë se shteti e ka për obligim ta kujtojë sakrificën e atyre që kanë kontribuar për lirinë e vendit dhe MKRS-ja po investon për krijimin e kushteve për dokumentimin e tillë. "Si ministre jam e nderuar që sot po e vëmë gurthemelin e kullës së familjes Canolli. Kjo kullë do të flasë shumë. Çdo tullë e kësaj kulle do ta tregojë historinë e popullit tonë, historinë e Gollakut dhe të gjithë përpjekjes sonë për liri. Dua ta falënderoj familjen që na ka qëndruar afër për realizimin e këtij projekti", ka thënë ministrja Dumoshi.

Ministrja vlerësoi se duke i nderuar luftëtarët tanë e gjakun tonë ne do ta gëzojmë lirinë dhe ky investim i ministrisë është një dokumentim i historisë sonë të lavdishme që ajo mos të harrohet. "I kemi gjeneratat që vijnë pas, fëmijët tanë. Duhet t'u tregojmë për rrugëtimin e Basriut dhe të shokëve të tij të cilët kanë rënë për liri", ka porositur ministrja. MKRS-ja për realizimin e këtij projekti do të investojë mbi 60 mijë euro dhe pritet të finalizohet për katër muaj kalendarikë.

Pezullohet ofrimi i shërbimeve në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në Viti

PRISHTINË, 18 QERSHOR (ER) - Agjencia e Regjistrimit Civil e Ministrisë së Punëve të Brendshme ka njoftuar qytetarët e Republikës së Kosovës se në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në Viti një zyrtar i kësaj qendre ka rezultuar pozitiv me Covid-19. Për shkak rrezikut nga përhapja e Covid-19 është marrë vendim që Qendra e Regjistrimit të

Automjeteve dhe Qendra për Pajisje me Dokumente ta pezullojë ofrimin e shërbimeve me palë. Stafi i dy qendrave është duke iu nënshtruar testit për Covid-19 dhe deri në marrjen e rezultateve dhe konfirmimit nga QKMF në Viti dhe nga Instituti Kombëtar të Shëndetësisë Publike, këto dy qendra do të jenë të mbyllura. "Deri në përfundimin e këtij

procesi të gjitha shërbimet e Regjistrimit të Automjeteve do të bëhen në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në qytetin e Gjilanit, ndërsa shërbimet për Pajisje me Dokumente do të bëhen në qendrat e komunave më të afërta. Me këtë rast kërkojmë mirëkuptimin e të gjithë qytetarëve të Komunës së Vitisë", thuhet në njoftimin e MPB-së.



Shtyhet testi i arritshmërisë dhe testit të maturës shtetërore



PRISHTINË, 18 QERSHOR (ER) - Ministri i Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), Ramë Likaj, ka marrë vendim që të shtyhet data e

mbajtjes së testit të arritshmërisë dhe testit të maturës shtetërore. "Këtë vendim ministri Likaj e ka marrë në konsultim me Ministrinë e Shëndetësisë

dhe IKShP-në për shkak të situatës epidemiologjike në ditët e fundit dhe me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik. Sipas vendimit, datat e reja për mbajtjen e këtyre

testeve janë: Testi i arritshmërisë do të mbahet më 20. 08. 2020, kurse testi i maturës do të mbahet më 29. 08. 2020", është bërë me dije në njoftimin e MASHTI-t.

UKZ-ja merr kryesimin e radhës së Konferencës së Rektorëve

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

GJILAN, 18 QERSHOR - Konferenca e Rektorëve e Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës ka zhvilluar takimin e radhës, ku nga dita e enjte kryesimin e saj do ta ketë rektori i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, prof. asoc. dr. Bajram Kosumi. Në këtë konferencë kanë marrë pjesë rektorët e universiteteve publike në Republikën e Kosovës, kurse për shkak të situatës së krijuar ditët e fundit nga Covid-19 është reduktuar numri i mysafirëve të ftuar.

Mbledhjen e ka hapur prof. dr. Fadil Millaku, rektori i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, njëherësh kryesuese i konferencës. Më pas rektorët unanimisht kanë zgjedhur kryesuesin e Konferencës së

Rektorëve, prof. asoc. dr. Bajram Kosumi, rektori i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, kurse prof. dr. Alush Musaj, rektori i Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, është zgjedhur zëvendëskryesues. Pas votimit është bërë edhe bërë pranim-dorëzimi i kryesimit të konferencës.

Rektori i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, i cili ka dorëzuar kryesimin te rektori i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, ka thënë se ishte privilegj për të punuar së bashku me të gjithë në ngritje të cilësisë dhe vlerave të universiteteve publike të Kosovës gjatë mandatit sa ishte kryesues i konferencës.

Kurse rektori Bajram Kosumi ka falënderuar të gjithë për pjesëmarrje, njëherësh ka përgëzuar rektorin Millaku për kryesimin e deritashëm të konferencës.



Rektori Kosumi ka thënë se që nga viti 2016 kur është themeluar Konferenca e Rektorëve e deri më tani është bërë mjaft punë e mirë duke mbrojtur arsimin e lartë dhe cilësinë e arsimit nga politikat shkurtpamëse. Ai e ka falënderuar Arsim Bajramin, në

atë kohë ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë, për ndihmën dhënë në themelimin e Konferencës së Rektorëve.

Rektori Kosumi ka thënë se do të vazhdojë të punojë për orientimin e politikave programore në institucionet

publike të arsimit të lartë, për ngritjen e cilësisë në arsim për studentët, në mobilitet dhe hulumtime, në promovime shkencore dhe shkëmbim të përvojave. Rektori Kosumi i ka ftuar të gjithë që t'i mbështesin universitetet dhe të besojnë në arsimin cilësor në Kosovë.

Ministri Likaj takohet me donatorët dhe partnerët zhvillimorë të arsimit



PRISHTINË, 18 QERSHOR (ER) - Ministri i Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Ramë Likaj, është takuar të enjten me donatorët dhe partnerët zhvillimorë në arsim, me të cilët ka biseduar për gjendjen në arsim dhe për përkrahjen e tyre në të gjitha nivelet e arsimit në vend.

Gjatë takimit Likaj ka theksuar ndihmën që kanë dhënë

partnerët në situatën pandemike sa i përket mësimin në distancë, por edhe për orientimin e mbështetjes në përgatitjet për situata të reja të mundshme për fillimin e vitit të ri shkollor dhe atij akademik. Ai ka thënë se në këtë situatë ka nevojë edhe për këshilla dhe rekomandime nga partnerët në arsim dhe ka shprehur gatishmërinë që t'i koordinojë

aktivitetet e përbashkëta të MASH-it dhe partnerëve të arsimit.

Ndërsa përfaqësuesit e organizatave partnere në arsim kanë shprehur gatishmërinë që të vazhdojnë ta mbështesin arsimin përmes projekteve që janë duke u realizuar, por edhe për iniciativa të reja rreth menaxhimit të situatës me Covid-19.

OSBE-ja do t'i grumbullojë në Kosovë votat e zgjedhjeve parlamentare të Serbisë

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) ka njoftuar se më 21 qershor do ta bëjë grumbullimin e votave për zgjedhjet parlamentare të Serbisë. "Ky operacion është në përputhje me praktikën e kaluar dhe modalitetet e zbatuara më 2017", ka thënë ky Mision për REL-in. Aty, po ashtu, është bërë me dije se

kjo kërkesë është pranuar nga Beogradi dhe se marrëveshja është arritur me autoritetet e Kosovës.

Zgjedhjet parlamentare në Serbi do të mbahen më 21 qershor.

Më 2017 zgjedhjet presidenciale të Serbisë janë zhvilluar në të njëjtën mënyrë.

Pas mbylljes së qendrave të votimit, votat nga Kosova janë dërguar në qytete të cilat janë

dhjetëra kilometra larg. Këtë model, që ishte harmonizuar me OSBE-në, Gjykata Kushtetuese e Serbisë e ka vlerësuar antikushtetues.

I njëjti është kritikuar nga opozita serbe sepse, sipas saj, kjo gjë bëri që "të njihet shtetësia e Kosovës". Zyrtarët serbë kanë thënë më herët se nga 8 386 vendvotime, ku do të zhvillohet votimi, 90 janë në Kosovë, aq sa kanë qenë në vitet e kaluara.



Rreth 120 punëtorë shëndetësorë të infektuar me Covid-19



PRISHTINË, 18 QERSHOR - Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve Shëndetësorë, Blerim Sylja, ka thënë se janë rreth 120 punëtorë shëndetësorë në Kosovë që janë infektuar me Covid-19. Në një

përgjigje me shkrim për "Radion Evropë e Lirë", Sylja ka thënë se ky numër i të infektuarve është shumë shqetësues. Ai, po ashtu, ka thënë se një numër i madh i punëtorëve të këtij sektori janë në vetizolim.

"Rreth 500 punëtorë shëndetësorë, pas kontakteve që kanë pasur, janë në izolim", ka thënë Sylja.

Zyrtarë të Ministrisë së Shëndetësisë nuk kanë dhënë ndonjë koment lidhur me këto

shifra. Sipas të dhënave të fundit, në Kosovë, që prej shfaqjes së rasteve të para me Covid-19 më 13 mars e deri më tash janë regjistruar 1 833 raste. Prej tyre, 968 janë shëruar dhe 34 pacientë kanë vdekur.

KRU "Prishtina" paralajmëron borxhlinjtë se nga 1 korriku procedura e borxhit kalon te përmbaruesit

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" ka njoftuar se duke filluar nga 1 korriku do të fillojë t'i procedojë te përmbaruesi të gjithë borxhlinjtë. Për të shmangur këtë procedurë e cila ka edhe shpenzime shtesë, kompania u bënë thirrje konsumatorëve që t'i shlyejnë borxhet e mbledhura deri me këtë datë. "KRU 'Prishtina' ju njofton se, duke filluar nga data 1 korrik 2020, do ta vazhdojë procedimin e

konsumatorëve borxhlinj në procedurë përmbarimore te përmbaruesit privatë. Inicimi i kësaj procedure përmes përmbaruesve privatë do të krijojë shpenzime shtesë dhe do ta vështirësojë përbushjen e obligimit tuaj duke paguar taksën shtesë", ka njoftuar KRU "Prishtina", duke theksuar se për t'iu shmangur kësaj procedure, konsumatorët duhet të reflektojnë në kohë sa më të shkurtër dhe ta përbushin obligimin që kanë ndaj KRU "Prishtina".

Kjo kompani ka bërë me dije se qëllim kryesor e ka ofrimin e

shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm për të gjithë konsumatorët në zonën e shërbimit. "Për të përbushur këtë mision me sukses dhe për të ofruar furnizim stabil me ujë të pijshëm dhe cilësor, sigurisht se kërkohet angazhim maksimal dhe ka kosto të lartë në trajtimin e ujit dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit në vazhdimësi. Në mënyrë që t'ju ofrohet ky shërbim cilësor, kërkohet nga ju që ta përbushni obligimin tuaj ndaj pagesës së faturave të rregullta mujore për shpenzimin e ujit", theksohet në njoftimin e KRU "Prishtina".



MTI-ja merr vendim të ri për bizneset e gastronomisë



PRISHTINË, 18 QERSHOR (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka bërë me dije se, me qëllim të mbrojtjes së jetës së qytetarëve nga pandemia Covid-19, si ministër i Tregtisë dhe Industrisë ka nënshkruar një urdhëresë për aplikimin e masave për parandalimin e luftimit të Covid-19 në sektorin e gastronomisë. Siç ka bërë me dije Krasniqi, përmes kësaj urdhërese ka kërkuar zbatimin e masave që dalin nga Plani Kombëtar i Reagimit ndaj këtij virusi. "Përmes kësaj urdhërese kam

kërkuar zbatimin e masave që dalin nga Plani Kombëtar i Reagimit ndaj këtij virusi, rekomandimeve që janë dhënë nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike dhe Manualin e Ministrisë së Shëndetësisë. Urdhëresa duhet të zbatohet nga të gjitha bizneset e gastronomisë dhe Inspektorati i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në bashkëpunim me inspektoratet e tjera do të jenë në terren çdo ditë për zbatimin e masave për t'u mbrojtur nga pandemia", ka shkruar Krasniqi në profilin e vet në "Facebook".

Agjencia e Metrologjisë verifikon peshoret e mullinjve para sezonit të korrje-shirjeve

PRISHTINË, 18 QERSHOR (ER) - Agjencia e Metrologjisë së Kosovës, e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI), ka verifikuar peshoret e mullinjve para sezonit të korrje-shirjeve, që fermerët të jenë të mbrojtur dhe peshat të maten saktë. Inspektorati i Tregut dhe Agjencia e Metrologjisë kanë

kryer verifikimin e jashtëzakonshëm të mjeteve matëse ku është bërë kontrolli ligjor. Kryeshefi i Agjencisë së Metrologjisë, Ferki Fejza, ka deklaruar se ky është edhe një hap tutje për mbrojtjen e konsumatorit që, sipas tij, është prioritet i ministrit Vesel Krasniqi.

Fejza tha se verifikimet të tilla do të bëhen edhe në ditët e ardhshme, që të mbrohet konsumatori nga mashtrimet e mundshme. Inspektorati dhe Agjencia e Metrologjisë së Kosovës bëjnë thirrje që të gjithë përdoruesit e mjeteve matëse të verifikohen që të zbatohet Ligji për Metrologji.



Komuna e Malishevës urdhëron bartjen e maskave mbrojtëse kundër Covid-19



MALISHEVË, 18 QERSHOR (ER) - Kryetari i komunës së Malishevës, Ragip Begaj, duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe në pajtim me statutin e komunës së Malishevës, ka lëshuar një urdhëresë administrative, me anë të së cilës

urdhërohet përdorimi i detyrueshëm i maskave mbrojtëse dhe dorëzave mjekësore për të gjithë stafin gjatë orarit në vendin e punës. Po me këtë urdhëresë edhe personat fizikë dhe përfaqësuesit e personave juridikë janë të

obliguar të mbajnë maska dhe dorëza mjekësore si dhe ta mbajnë distancën sociale gjatë kryerjes së punëve në administratën komunale. Këto masa mbrojtëse janë marrë me qëllim të mbrojtjes dhe mospërhapjes së koronavirusit.

UKZ-ja merr kryesimin e radhës së Konferencës së Rektorëve

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

GJILAN, 18 QERSHOR - Konferenca e Rektorëve e Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës ka zhvilluar takimin e radhës, ku nga dita e enjte kryesimin e saj do ta ketë rektori i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, prof. asoc. dr. Bajram Kosumi. Në këtë konferencë kanë marrë pjesë rektorët e universiteteve publike në Republikën e Kosovës, kurse për shkak të situatës së krijuar ditët e fundit nga Covid-19 është reduktuar numri i mysafirëve të ftuar.

Mbledhjen e ka hapur prof. dr. Fadil Millaku, rektori i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, njëherësh kryesuese i konferencës. Më pas rektorët unanimisht kanë zgjedhur kryesuesin e Konferencës së

Rektorëve, prof. asoc. dr. Bajram Kosumi, rektori i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, kurse prof. dr. Alush Musaj, rektori i Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, është zgjedhur zëvendëskryesues. Pas votimit është bërë edhe bërë pranim-dorëzimi i kryesimit të konferencës.

Rektori i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, i cili ka dorëzuar kryesimin te rektori i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, ka thënë se ishte privilegj për të punuar së bashku me të gjithë në ngritje të cilësisë dhe vlerave të universiteteve publike të Kosovës gjatë mandatit sa ishte kryesues i konferencës.

Kurse rektori Bajram Kosumi ka falënderuar të gjithë për pjesëmarrje, njëherësh ka përgëzuar rektorin Millaku për kryesimin e deritashëm të konferencës.



Rektori Kosumi ka thënë se që nga viti 2016 kur është themeluar Konferenca e Rektorëve e deri më tani është bërë mjaft punë e mirë duke mbrojtur arsimin e lartë dhe cilësinë e arsimit nga politikat shkurtpamëse. Ai e ka falënderuar Arsim Bajramin, në

atë kohë ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë, për ndihmën dhënë në themelimin e Konferencës së Rektorëve.

Rektori Kosumi ka thënë se do të vazhdojë të punojë për orientimin e politikave programore në institucionet

publike të arsimit të lartë, për ngritjen e cilësisë në arsim për studentët, në mobilitet dhe hulumtime, në promovime shkencore dhe shkëmbim të përvojave. Rektori Kosumi i ka ftuar të gjithë që t'i mbështesin universitetet dhe të besojnë në arsimin cilësor në Kosovë.

Ministri Likaj takohet me donatorët dhe partnerët zhvillimorë të arsimit



PRISHTINË, 18 QERSHOR (ER) - Ministri i Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Ramë Likaj, është takuar të enjten me donatorët dhe partnerët zhvillimorë në arsim, me të cilët ka biseduar për gjendjen në arsim dhe për përkrahjen e tyre në të gjitha nivelet e arsimit në vend. Gjatë takimit Likaj ka theksuar ndihmën që kanë dhënë

partnerët në situatën pandemike sa i përket mësimin në distancë, por edhe për orientimin e mbështetjes në përgatitjet për situata të reja të mundshme për fillimin e vitit të ri shkollor dhe atij akademik. Ai ka thënë se në këtë situatë ka nevojë edhe për këshilla dhe rekomandime nga partnerët në arsim dhe ka shprehur gatishmërinë që t'i koordinojë

aktivitetet e përbashkëta të MASH-it dhe partnerëve të arsimit. Ndërsa përfaqësuesit e organizatave partnere në arsim kanë shprehur gatishmërinë që të vazhdojnë ta mbështesin arsimin përmes projekteve që janë duke u realizuar, por edhe për iniciativa të reja rreth menaxhimit të situatës me Covid-19.

OSBE-ja do t'i grumbullojë në Kosovë votat e zgjedhjeve parlamentare të Serbisë

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) ka njoftuar se më 21 qershor do ta bëjë grumbullimin e votave për zgjedhjet parlamentare të Serbisë. "Ky operacion është në përputhje me praktikën e kaluara dhe modalitetet e zbatuara më 2017", ka thënë ky Mision për REL-in. Aty, po ashtu, është bërë me dije se

kjo kërkesë është pranuar nga Beogradi dhe se marrëveshja është arritur me autoritetet e Kosovës.

Zgjedhjet parlamentare në Serbi do të mbahen më 21 qershor.

Më 2017 zgjedhjet presidenciale të Serbisë janë zhvilluar në të njëjtën mënyrë.

Pas mbylljes së qendrave të votimit, votat nga Kosova janë dërguar në qytete të cilat janë

dhjetëra kilometra larg. Këtë model, që ishte harmonizuar me OSBE-në, Gjykata Kushtetuese e Serbisë e ka vlerësuar antikushtetues.

I njëjti është kritikuar nga opozita serbe sepse, sipas saj, kjo gjë bëri që "të njihet shtetësia e Kosovës". Zyrtarët serbë kanë thënë më herët se nga 8 386 vendvotime, ku do të zhvillohet votimi, 90 janë në Kosovë, aq sa kanë qenë në vitet e kaluara.



Rreth 120 punëtorë shëndetësorë të infektuar me Covid-19

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve Shëndetësorë, Blerim Sylja, ka thënë se janë rreth 120 punëtorë shëndetësorë në Kosovë që janë infektuar me Covid-19. Në një

përgjigje me shkrim për "Radion Evropë e Lirë", Sylja ka thënë se ky numër i të infektuarve është shumë shqetësues. Ai, po ashtu, ka thënë se një numër i madh i punëtorëve të këtij sektori janë në vetizolim.

"Rreth 500 punëtorë shëndetësorë, pas kontakteve që kanë pasur, janë në izolim", ka thënë Sylja.

Zyrtarë të Ministrisë së Shëndetësisë nuk kanë dhënë ndonjë koment lidhur me këto

shifra. Sipas të dhënave të fundit, në Kosovë, që prej shfaqjes së rasteve të para me Covid-19 më 13 mars e deri më tash janë regjistruar 1 833 raste. Prej tyre, 968 janë shëruar dhe 34 pacientë kanë vdekur.

21 vjet nga çlirimi i Skenderajt, Jashari bën thirrje për unitet

SKENDERAJ, 18 QERSHOR (ER) - Komuna e Skenderajt ka shënuar të enjten 21-vjetorin e çlirimit. Kjo datë është shënuar me nderime te shtatorja e komandantit legjendar Adem Jashari në sheshin e qytetit, duke vazhduar me nderime te kompleksi memorial "Adem Jashari" në Prekaz.

Gjatë nderimit te varrezat e familjes Jashari, kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, ka thënë se lufta e familjes Jashari dhe dëshmorëve të tjerë është gurthemeli i ndërtimit të shtetit tonë. "Lufta heroike e komandantit legjendar Adem Jashari, babës Shaban, babushit

(Hamëzës), anëtarëve të familjes Jashari dhe gjithë të rënëve në altarin e lirisë, u bë gurthemel i fortë i pavarësisë sonë. 21 vjet pas ende janë të freskëta kujtimet dhe emocionet që kishim në ditën e çlirimit dhe kthimit tim në vendlindje, takimi im me Besartën dhe vizita te kompleksi memorial", ka thënë Jashari.

I pari i Komunës së Skenderajt ka bërë thirrje për unitet politik dhe për punë të vazhdueshme për ta jetësuar amanetin e dëshmorëve që u flijuan për lirinë e vendit. "Është një ditë e madhe për qytetin tonë, por edhe për të gjithë shqiptarët. Por, për fat të



keq, ende nuk është dita për të cilën kanë rënë këta dëshmorë, kështu që uroj që vitet e tjera t'i presim më mirë, të kemi mendje të shëndoshë, ta duam njëri-

tjetrin, të kemi unitet mes vete dhe dashuri për vendin tonë", ka thënë Jashari.

Ndërsa kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës, Hysni

Gucati, është shprehur i pakënaqur me gjendjen në të cilën sot ndodhen disa familje të dala nga lufta. "Sot në 21-vjetorin e çlirimit të vendit një pjesë dërmuese e invalidëve dhe veteranëve, por edhe disa familjarë të dëshmoreve, janë në gjendje jo të mirë ekonomike. Në emër të Organizatës së Veteranëve të Luftës dhe në emër të gjithë veteranëve, sot dua ta uroj Drenicën për Ditën e Çlirimit", është shprehur Guçati. Homazhe në nderim të luftës së shenjtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë bërë edhe në Kompleksin Memorial të Dëshmorëve në Marinë.

Kamenica me seancë solemne shënon 21-vjetorin e çlirimit

KAMENICË, 18 QERSHOR (ER) - Komuna e Kamenicës, në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, për nder të 18 Qershorit, Ditës së Çlirimit, ka mbajtur disa aktivitete. Fillimisht janë bërë homazhe te varrezat e dëshmorëve në lagjen "Malësia", ku nënkryetari i komunës, Faton Jakupi, së bashku me kryetarin e veteranëve të luftës së UÇK-së, Milaim Limani, dhe zyrtarë nga komuna, kanë nderuar dëshmorët e rënë.

Aktiviteti për nder të Ditës së Çlirimit ka vazhduar me mbajtjen e një seance solemne të

Kuvendit Komunal në Shkollën Fillore "Dëshmorët e Kombit". Kryetari i Kamenicës, Qëndron Kastrati, në një lidhje direkte, ka uruar të gjithë të pranishmit për Ditën e Çlirimit, duke thënë se, ndonëse në kushte të jashtëzakonshme në distancë, të gjithë duhet të jemi të bashkuar në idetë dhe qëllimet e përbashkëta. "18 qershori i vitit 1999 është një datë që i rikthehem me krenari e vullnet. Sepse kjo kohë shënon ndryshimin e rrjedhës së historisë për shoqërinë tonë, nga robëria në çlirim, nga sundimi në pavarësim. Kur kthehem i refletojmë për këtë datë



s'mund të mos e mendojmë një nga përcaktuesit kryesor të saj. Ky përcaktues është padyshim ëndrra. Ëndrra e atyre që rezistuan. Ëndrra e atyre që u përkushtuan. E atyre që sakrifkuan. E

atyre që shpresuan", ka thënë Kastrati, i cili është i diagnostifikuar me Covid-19.

Më tutje, ai ka ftuar të gjithë qytetarët e Kamenicës, që krenarinë e 18 qershorit ta përk-

thejnë në punë dhe dashurinë për vendin ta shprehin me respekt ndaj tjetrit. Ndërsa nënkryetari Faton Jakupi i ka uruar të gjithë qytetarët e Kamenicës për Ditën e Çlirimit, duke kujtuar të kaluarën dhe vlerat e atyre që u sakrifkuan për liri. Në anën tjetër, kryetari i veteranëve të luftës së UÇK-së në Kamenicë, Milaim Limani, ka thënë se pa gjakun e dëshmorëve nuk do të mund ta gëzonin këtë ditë. Këto aktivitete janë përmbyllur me ekspozitën e fotografive dhe dokumentarin që pasqyron 18 qershorin e vitit 1999.

Lladrovci raporton para qytetarëve për punën gjashtëmujore

DRENAS, 18 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka mbajtur takim me qytetarët, para të cilëve ka raportuar për punën gjashtëmujore të këtij viti dhe për planifikimin e punëve për pjesën e dytë të vitit 2020. Takimi është mbajtur në sallën e Shtëpisë së Kulturës për shkak të mbajtjes së distancës ndërmjet pjesëmarrësve. Në këtë takim kanë marrë pjesë



drejtorë të drejtorive komunale, kryetarë të vendbanimeve, përfaqësues të lagjeve dhe qytetarë, me të cilët është diskutuar për aktivitetet e Komunës së Drenasit

të kryera për pjesën e parë të vitit.

Takimin e ka hapur udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, Bekim Dobra, i cili ka treguar për rëndësinë e këtij takimi me publikun dhe ka treguar se njoftimi është bërë me kohë dhe sipas ligjit.

Ndërsa kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka falënderuar të pranishmit për pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin e treguar gjatë

pandemisë dhe për realizimin e projekteve. Lladrovci ka raportuar për ta gjitha punët e kryera gjatë kësaj kohe, për sfidat me pandeminë globale Covid-19 dhe për realizimin dhe ngecjen e projekteve kapitale. "Deri në muajin maj kemi pasur vështirësi për realizimin e projekteve kapitale për shkak se niveli qendror na ka pamundësuar të zhvillojmë procedurë të prokurimit, por vetëm për një muaj, pra nga muaji maj e deri më tani, janë në proces për realizimin e projekteve mbi 2 mil-

ionë euro dhe me këtë trend të realizimit deri në përfundimin e këtij viti, besoj se do t'i realizojmë të gjitha projektet e planifikuara për këtë vit, përkundër sfidave që kanë dalë nga pandemia globale", ka thënë Lladrovci.

Të pranishmit kanë shtruar pyetje dhe kanë dhënë propozime dhe sugjerime për përfaqësuesit e zgjedhur komunalë lidhur me realizimin e projekteve të planifikuara për gjashtëmujorin e parë të vitit 2020 dhe ato që janë të planifikuara për pjesën tjetër të vitit.

I jepet lamtumira e fundit aktivistit të Nismës, Limaj thotë se ishte aktivist i jashtëzakonshëm

Lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka marrë pjesë në ceremoninë së varrimit të aktivistit të kësaj partie, Albert Krasniqi, i cili ka ndërruar jetë tragjikisht. Limaj ka thënë se Krasniqi ishte aktivist i jashtëzakonshëm i Nismës, duke i shprehur ngushëllime familjes dhe miqve të tij, raporton "Epoka e re".

"Shumë e vështirë për të gjithë ne, t'i jepnim sot lamtumirën e fundit Albertit, një djali shembullor, aktivistit tonë të jashtëzakonshëm. Na le shpejt, Albert! Ngushëllimet më të sinqerta familjes Krasniqi dhe gjithë miqve të tij. Dritë të pastë shpirti, Albert!", ka shkruar Limaj në llogarinë e vet në "Facebook".



Lavdia u takon atyre që flijohen për vizione të mëdha (10)

FILLIMI I NJE MEDITIMI PER EMRIN



Bedri ISLAMI

Pa as më të voglin dyshim që emri i Adem Jasharit është ndër më të njohurit dhe më të respektuarit në të gjitha trevat shqipfolëse dhe në bashkëkombësit e tij. Është ndër rastet e rralla të historisë njerëzore, jo vetëm të kombit tonë, kur emri i njeriut, në fare pak kohë, i dalë si nga legjenda, bëhet simboli i popullit të tij. Tashmë, ndryshe nga 5 marsi i vitit 1998, kur ishte e zakonshme të pyetesh se “kush është Adem Jashari”, (pyetja ngeli pa përgjigje vetëm në një ditë lufte) rreth emrit të tij është ngritur miti, legjenda dhe e vërteta. Sa lidhje kanë ato me njëra-tjetrën, ku është fillesa e njërit dhe vazhdimi i tjetrës, në cilin kufi ndahen ata nga njëra-tjetra apo, të tria së bashku, duke mos qenë, veçse vazhdimi i njëra-tjetrës, përbëjnë atë që sot mund të quhet “çmimi Nobel i lirisë”, si është shprehur në ditët e para të pasluftës, ministri i sotëm i Jashtëm francez, Bernard Kuschner.

Në historinë e kombeve, si dhe në historinë e kombit tonë, ka jo pak shembuj, për të mos thënë se ka mjaft të tillë, në të cilat sakrificat sublimë, qëndresa, përkushtimi, janë shfaqur si simbole, nga të cilat është mbajtur gjallë historia. Kjo ka ndodhur edhe te ne. I janë dashur kombit tonë simbole të herëpashershme, të cilët kanë marrë pas vetes edhe të ardhmen, në një mënyrë ose në një tjetër ata janë bërë fatthënësit dhe dalzotësit e kombit që i kanë takuar. Mirëpo, ata kanë mbajtur një brez, një ngjarje, një qëndresë, një luftë, kanë pasur një përkushtim, janë ngritur mbi epokën e tyre, duke u bërë pjesë edhe e epokave që do të vinin. Brezat janë përkulur në nderim të veprës dhe qëndresës së tyre.

Sidoqoftë, në këtë plejadë qëndrese, në të cilat janë ndeshur burra që kanë zgjidhur hallet e popullit të tyre me armë dhe burra që u kanë paraprirë me pendë, ka qenë pa dyshim saktësisht e qartë, se miti i krijuar mbi jetën dhe luftën e tyre, aq sa ka qenë i vërtetë, aq ka qenë dhe njerëzor, aq sa ka qenë i saktë, aq ka pasur edhe përmasat e së panjohurës, në të cilat vitet dhe dekadat kanë sjellë zbehjen ose, jo rrallë, edhe rëndimin e kujtesës.

Ata që qëndruan në memorien e kombit si të përhershëm nuk e bënë vetë këtë, thënë të drejtën as nuk e deshën këtë, por gjithçka

erdhi natyrshëm, deri sa njerëzit i bënë pjesë të jetës së tyre të përditshme.

Por rasti i Familjes Jashari ishte i një natyre krejt të veçantë. Për t'u ngritur miti i tyre nuk u deshën vite të shumta e as dekada, nuk u desh që të trasohej rruga, të qetësoheshin ngjarjet, të merrnin rrugë ato; miti i tyre u ngrit vetvetëshëm dhe kjo ndodhi që të nesërmen e rënies së tyre.

Kjo nuk kishte ndodhur asnjëherë, kjo nuk kishte ndodhur as në rastin e famëmadhit dhe burrit më të shquar të kombit tonë, Gjergj Kastriotit. Në rastin e mësipërm, të Gjergjit, ai kaloi përmes tri fazave, në të cilët kalojnë personalitetet e mëdha të historisë. Si e cilëson Fan Noli, në librin e tij mbi jetën dhe veprën e Skënderbeut, emri i tij kaloi përmes glorifikimit që i bënë bashkëkombësit e tij, pastaj përmes mohimit të plotë që i bënë ata që erdhën pas tij, dhe së fundi - në drejtpeshimin e gjërave dhe ngritjen e lavdisë së përditshme.

Adem Jashari nuk kaloi përmes një rruge kaq të gjatë. Ai e kishte pasur një fat tjetër, ai e kishte pasur mohimin para se të vinte dita e 5 marsit dhe rrethimi për herë të tretë i Kullave të Jasharëve. Ai, si të thuash, kishte kaluar përmes së keqes që vinte nga zyrat e Velanisë, nga mallkimet e përbaltjet që i hidhnin prej andej, kishte fshirë me mantelin e tij të luftës përbuzshëm gjithë mllëfin dhe helmin që rridhte si ujërat e shirave dhe kishte bërë më tutje. Në se kishte qenë i lëçitur nga politika e ditës së Prishtinës, Adem Jashari kishte pasur fatin, që duke i takuar një popull që i kishte besuar, kishte ecur në rrugën e tij, e cila ishte tejet e pakrahueshme me rrugëzimet e pafund, herë gjysmë sllave dhe herë gjysmë përçarëse të njeriut që kishte lëçitur luftëtarët. Përpjekjet që bëhen sot, për të vënë një linjë barazimi mes njeriut lëçitës, të cilit nuk i përmend emrin për të mos e vënë pranë emrit të Jasharëve, janë veçse dështime të tjera të politikës ditore. Për më tepër ata janë të dhimbshme, kur bëhen nga njerëz që i kanë takuar një mendimi të ri politik dhe filozofie të re politike në Kosovë.

Rikthim tek ideja e ujëvarës, lumit dhe deti të lirisë

Kam shkruar më sipër se fillimisht Adem Jashari do të jetë një ujëvarë lirie, do të kthehet pastaj në lum që rrjedh drejt lirisë, për t'u kthyer në det lirie. Si ndodhi kjo?

- Përse ndodhi, menjëherë pas rënies, mitizimi i Adem Jasharit dhe ngritja e legjendës së tij?

- Ishte një rastësi, një thirrje e

kohës, pasi populli kishte nevojë për një mit dhe për një legjendë, ishte kërkesë apo gjithçka ishte e vërtetë dhe kjo e vërtetë po fillonte të bëhej qartësisht e lexueshme për të gjithë, për pasuesit e tij, por edhe për mohuesit e tij?

Që pas 8 marsit të vitit 1998 emri i Adem Jasharit, bacës Shaban, Hamzës, dajës Osman dhe i gjithë atyre që luftuan në atë fillim marsi, i kullave që u shkruan, i jetës që u dha, i pushkëve që u ngritën, i luftës deri në sublimitet, u bënë fillesa e simbolit të popullit që i takonin. Për këtë nuk u desh asnjë dekret, dhe si të tillë askush nuk mund ta nxirrte, nuk u mor asnjë vendim, nuk u bë asnjë mbledhje e veçantë, gjithçka rrodhi krejt natyrshëm, tepër njerëzore, sublimë do të thosha, deri në atë kufi ku kufiri mes mitit, legjendës dhe të vërtetës, nuk është kurrë qartësisht i përcaktuar, sidomos në ditët e para.

A kishte një shkak tjetër, po ashtu aq madhor dhe sublim, sa edhe rënia e tyre, që solli mitizimin e menjëhershëm të Adem Jasharit? - Sigurisht që po. Në ditët e para të pasrënies së tij dhe bashkëluftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ka qenë e natyrshme që ana figurative, emocionale, e prekshme, e dhimbshme, më e kapshme - lufta, qëndresa dhe sakrificat, të ishin më evidentet.

Mirëpo këto nuk mjaftojnë për të bërë një mit, ata shumë - shumë mund të bëjnë një shembull, një prijës të ditës, një emër për t'u ndjekur, ata mund të bëjnë një këngë ose shumë këngë - por nuk mund të bëjnë mitin Njeri, nuk

mund të hedhin bazamentin e legjendës, e cila në këtë rast, nuk është asgjë tjetër, veçse e vërteta. Për të kaluar nga emri i njeriut luftëtar, jo shumë i njohur jashtë Drenicës dhe jo shumë i njohur jashtë strukturave të organizuara të luftës, Adem Jasharit nuk iu deshën më shumë se 48 orë. Që nga dita kur kishte vendosur të zgjidhte çështjen e Kosovës përmes pushkës dhe deri në ditën e rënies së tij, ishin më shumë se dhjetë vite aktivitet ilegal, legal e gjysmë legal, mirëpo edhe kjo nuk do të ishte e mjaftueshme për të shpjeguar mitin e jashtëzakonshëm të Jasharëve. Që nga dita kur ishin hedhur themelet e para të Fisit të Jasharëve në Prekaz dhe deri në ditën kur do të digjeshin për herë të fundit kullat e tyre do të kishin kaluar treqind vite - mirëpo edhe ky autoktonitet, nuk i ka të gjitha në vete.

Në Drenicë, por edhe jashtë saj, kishte pasur Kosova burra të mëdhenj, të ndritur do të thosha, të cilët ishin sakrifikuar deri ku nuk mbante më, dhe këtë e kishin bërë krejt natyrshëm, duke dhënë pasurinë, bijtë e bijat e tyre, duke e shkruar gjithë jetën luftëtare dhe në fund duke dhënë edhe jetën e tyre. Ata e kanë lënë emrin e tyre në historinë e kombit - mirëpo, kjo që po ndodhte në rastin e mitit të Jasharëve do të ishte diçka krejt e re dhe krejt ndryshe në historinë tonë.

Një shembull i përjetuar: me 9 mars 1998, pra dy ditë pas përfundimit të luftës në Prekaz, në qytetin e Shtutgartit, Lëvizja Popullore e Kosovës, do të organizonte një manifestim të

madh kundër dhunës dhe pushtimit serb të Kosovës. Ishte manifestimi i parë i madh që bëhej. Organizatorët kryesorë të tij ishin Kushtrim Hadergjonaj, Sheradin Berisha, Gëzim Avdimetaj e të tjerë. Së bashku me profesor Hasan Ukhaxhajn ishim ftuar, si drejtues të Lëvizjes, për të folur në këtë Manifestim. Në sheshin e madh ishin më shumë se njëzet mijë vetë.

Ende nuk dihej saktësisht se çfarë kishte ndodhur në Prekaz, lajmet vinin të paqarta deri në fund, as në familjen Jashari që jetonte në Mynih, ende asgjë nuk ishte e qartë. Pikërisht në këtë shesh, për herë të parë, pa kaluar as 48 orë nga vrasja e tyre, emri i Adem Jasharit gjëmoi. Kam parë njerëz që e thërrisnin emrin e tij me gjithë shpirt duke valëvitur flamurin kombëtar, sikur shpirti i tij ishte tashmë në palët e flamurit. Ishte një thirrje e re, krejt e veçantë, nga askush e orientuar, e dalë nga thellësia e shpirtit, megjithëse ende kishte shumë e shumë njerëz që pyesin se “kush është Adem Jashari”.

Një javë më vonë, Lidhja Demokratike e Kosovës, në qytetin e Mynihut, nuk lejoi të vihej fotografia e tij në qendër të manifestimit dhe kjo do të ishte nga përpjekjet e fundit të hapura për prishjen e mitit dhe çlegjendizimin e emrit të Adem Jasharit. Pak kohë më vonë, kam parë të njëjtët njerëz duke u përбетuar se kanë qenë miqtë më të mirë të tij dhe të familjes së tij. Por kjo është një histori tjetër. Unë kthehem edhe një herë tek pyetja ime:

- ishte rastësi, kërkesë e kohës apo ishte gjithçka e natyrshme, njerëzore dhe saktësisht e merituar?

Ne jemi mësuar ta shohim në fotografi të ndryshme Adem Jasharin, gjithnjë me armë në dorë, me pelerinën e luftës hedhur krahëve, me mjekrën e derdhur si ujëvarat e bjeshkëve të Sharrit, me shikimin e tij të papërsëritshëm - sytë e tij flasin më shumë se qindra deklarata, jemi mësuar edhe ta përfytyrojmë një njeri që vetëm ka luftuar, ka organizuar aksione, ka qëndruar, ka mposhtur armiqtë, ka ngrohur zemrat e njerëzve. Kështu jemi mësuar dhe të gjitha këto, duke qenë të vërteta, janë njëkohësisht edhe të paplota.

Njerëz që e kanë shkruar jetën me armë kemi pasur gjithnjë, me pelerinën hedhur krahëve kemi pasur po ashtu, që janë vrarë burrërisht me gjithë njerëzit e fisit të tyre, ka ndodhur edhe kjo; sepse na është dashur të luftojmë në shumë dekada. Ka pasur burra si Isë Boletini që në një thirrje të tyre ngrinin në këmbë deri në 15 mijë vetë dhe hynin në Shkup si në shtëpinë e tyre. (Vijon)



Edhe gjashtë të vdekur në Maqedoninë e Veriut nga Covid-19

SHKUP, 18 QERSHOR - Ministria e Shëndetësisë e Maqedonisë së Veriut të mërkurën ka njoftuar për gjashtë viktima nga Covid-19 dhe 182 persona të infektuar. Viktimat janë dy nga Shkupi, dy nga Kumanova dhe dy nga Tetova. Me këta, numri i përgjithshëm i të vdekurve nga sëmundja Covid-19 ka arritur në 216.

Sa iu përket të infektuarve, 107 janë nga Shkupi, 23 në Tetovë, 14 në Kumanovë, 13 në Resnje, ndërsa në nëntë qytete numri i të prekurve është më ulët se dhjetë.

Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, momentalisht rreth 330 pacientë pozitivë me koronavirus, janë të shtrirë në të gjitha institucionet e shën-

detit publik në Maqedoninë e Veriut. "Vatra më e madhe në vend janë disa vendbanime të Shkupit. Po punohet intensivisht për t'i identifikuar kontaktet, por mjekët-epidemiologë po përballen me pengesa të zakonshme, pasi ka njerëz që nuk tregojnë kontaktet apo fshehin simptomat. Të gjitha qytetet dhe rajonet e

tjera, përveç Shkupit dhe pjesërisht Tetovës, janë të qëndrueshme", thuhet në një njoftim të Ministrisë së Shëndetësisë. Gjatë 24 orëve janë testuar 1 348 mostra, ndërsa numri i përgjithshëm i testeve ka arritur në 47 793. Nga 4 664 të diagnostikuar me koron-



avirus, 2 612 ende janë aktivë, 216 kanë vdekur ndërsa 1 836 pacientë janë shëruar.

Turqia thotë se ka sulmuar mbi 500 caqe të militantëve kurdë në veri të Irakut

ANKARA, 18 QERSHOR - Ministria e Mbrojtjes e Turqisë ka njoftuar se ushtria turke ka sulmuar mbi 500 caqe të militantëve kurdë në veri të Irakut gjatë një operacioni kundër Partisë së Punëtorëve të Kurdistanit (PPK).

Operacioni kundër PPK-së nisi më 16 qershor si kundërpërgjigje ndaj disa sulmeve që militantët kurdë kryen ndaj bazave ushtarake të Turqisë, njoftoi Ministria.

Dy sulme të ndara ajrore që kishin për cak caqet e PPK-së në rajone të ndryshme në veri të Irakut u kryen më 14 dhe 16 qershor, thuhet në njoftimin e Ministrisë turke të Mbrojtjes, ku

shtohet se avionët luftarakë F-16, dronët dhe sulmet me murtaja kanë shkatërruar mbi 500 caqe të PPK-së gjatë 36 orëve të fundit. "Operacioni po shkon shumë mirë. Do Zoti, nëse vazhdojmë me të njëjtin seriozitet dhe vendosmëri, ne do ta përmbyllim këtë operacion me sukses", citohet të ketë thënë ministri turk i Mbrojtjes, Hulusi Akar.

PPK-ja, që njihet si organizatë terroriste nga Turqia, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian, pothuajse qe katër dekada është në kryengritje kundër shtetit turk, duke kërkuar më shumë të drejta për kurdët.

Që prej nisjes së kryengritjes, rreth 400 000 persona janë vrarë. Partia e Punëtorëve të Kurdistanit ka krah të armatosur dhe politik në Turqi, Irak, Iran dhe Siri. Po ashtu, ka qindra mijëra mbështetës të diasporës kurde në Evropë.

Turqia në vitet e fundit vazhdimisht ka kryer operacione ushtarake ndaj PPK-së në juglindje të Anadolit dhe sulme brenda territorit irakian.

Ushtria turke, po ashtu, ka kryer tri operacione kundër forcave kurde siriane, që kanë nën kontroll territor në veri të Siri dhe që Ankaraja konsideron se ato territore kontrollohen nga PPK-ja.



Vëllai i Floydit kërkon që OKB-ja ta hetojë racizmin dhe dhunën e policisë në ShBA



NJU JORK, 18 QERSHOR - Vëllai i George Floyd, afrikano-amerikanit që vdiq muajin e kaluar derisa ishte në mbajtje të policisë në Mineapolis, i ka bërë thirrje Këshillit për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara (UNHRC), që të nisë një hetim të pavarur mbi "vrasjen e personave me ngjyrë nga policia" në Shtetet e Bashkuara dhe "dhunës së ushtruar ndaj protestuesve paqësorë".

Philonise Floyd i bëri këto komente përmes një video-mesazhi të transmetuar në Këshillin në Gjenevë, teksa ky organ i OKB-së mbajti debatin mbi racizmin dhe brutalitetin e policisë.

Debati në këtë këshill të OKB-së u thirr me kërkesë të vendeve afrikane, të cilët po kërkojnë

nisjen e hetimeve lidhur me brutalitetin e policisë dhe diskriminimi racor në ShBA.

Ky debat pason protestat masive për javë të tëra në ShBA dhe në vendet e tjera të botës kundër brutalitetit të policisë dhe pabarazisë racore që u nxitën nga vdekja e Floyd më 25 maj. Floyd vdiq pasi gjatë arrestimit një polic me ngjyrë të bardhë i kishte bërë presion me gju në qafë për pothuajse nëntë minuta.

Vdekja e një personi tjetër me ngjyrë në ShBA, Rayshard Brooks, që u qëllua dy herë në shpinë nga policia në Atlanta më 12 qershor, nxiti protesta të dhunshme. "Ju në OKB keni fuqinë që të na ndihmoni të kërkojmë drejtësi për vëllanë tim, George Floyd", ka deklaruar

Philonise Floyd përmes një video-mesazhi. "Jeta e personave me ngjyrë në ShBA nuk ka vlerë. Siç e kam parë në incizim vëllanë tim teksa torturohej dhe vritej, është e njëjta mënyrë se si trajtohen njerëzit me ngjyrë nga policia në Amerikë", ka thënë Floyd.

Michelle Bachelet, zyrtare e lartë për të drejtat e njeriut në OKB, kritikoi "brutalitetin" që u përdor gjatë vrasjes së Floyd dhe paralajmëroi se kjo ngjarje po simbolizon "racizmin sistematik që prek miliona njerëz që kanë prejardhje afrikane".

Ndërkaq presidenti amerikan Donald Trump më 16 qershor nënshkroi një urdhër ekzekutiv që do t'i rrisë fondet për trajnimin e policëve gjatë arrestimeve të të dyshuarve.

OBK-ja: 1 për qind e popullsisë në botë, e zhvendosur

NJU JORK, 18 QERSHOR - Dhuna dhe persekutimi kanë detyruar pothuajse 80 milionë persona që të largohen nga shtëpitë e tyre, shifra që tregojnë për rritje të zhvendosjes në dekadën e kaluar, ka thënë Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Refugjatët, UNHCR.

Deri në fund të vitit të kaluar

një në 97 persona në botë është zhvendosur diku, është thënë në raportin e ri të kësaj agjencie. "Një për qind e popullsisë botërore nuk mund të shkojë nëpër vendlindjet për shkak të luftës, persekutimit, shkeljes së të drejtave të njeriut dhe formave të tjera të dhunës", ka thënë shefi i UNHCR-së, Filippo Grandi.

Të gjeturat kanë treguar se deri në fund të vitit 2019 një rekord prej 79.5 milionë personave janë duke jetuar si refugjatë, azilkërkues apo janë zhvendosur brenda shteteve të tyre.

Kjo shifër përbën rritje për 9 milionë në krahasim me vitin paraprak.

Afro 46 milionë prej personave të zhvendosur janë bartur

brenda vendeve të tyre, derisa 26 milionë kanë ikur përtej kufijve si refugjatë. "Ky është trend që ka vazhduar nga viti 2012: shifrat janë më të larta sesa secilin vit më parë", ka thënë Grandi, duke theksuar se kjo gjë nënkupton se "ka pasur më shumë konflikte dhe më shumë dhunë që ka shtyrë njerëzit të largohen nga



shtëpitë e tyre". Grandi ka thënë se 68 për qind e refugjatëve në botë janë nga pesë shtete: Siria, Venezuela, Afganistani, Sudani Jugor dhe Mianmari.

Portret i simbolit të rebelimit në Iran: Mos mendoni se jam harruar!



Nga: Matt SCHUDEL

Marjan, një këngëtare dhe aktore e njohur në Iranin para-revolucionar e cila, pas burgosjes nga autoritetet islamike të vendit në vitet 1980, ia fali zërin kauzës së lirisë politike në atdheun e saj, vdiq më 5 qershor në një spital në Los Angeles, në moshën 71-vjeçare.

Shkaku i vdekjes ishte komplikimi nga një operacion, siç thuhet në një deklaratë të Këshillit Kombëtar të Rezistencës së Iranit.

Marjan (emër arti për Shahla Safi Zamirin) ka aktruar në mbi 30 filma në gjuhën farsi në vitet 1960 dhe 1970 dhe ishte një nga artistet më të mirënjohura të Iranit përpara përmbysjes së shahut të mbështetur nga Perëndimi, më 1979. Ajo ka kënduar gjithashtu këngë shumë të dashura për iranianët, këngë që shpesh evokonin ndjenja nostalgjike.

Kur udhëheqësit islamikë të quajtur mullahë morën pushtetin në Iran, bërja e filmave u ndalua

përkohësisht dhe grave iu ndalua të këndonin në publik. Marjana iu bashkua një lëvizjeje opozitare për të luftuar kundër këtyre kufizimeve të sapovendosura dhe u arrestua për herë të parë më 1980 se pse kishte kënduar një këngë që përkthehet si "Atdheu": "Atdheu im, shtëpia ime, nuk kam vend tjetër veçse këtu, nuk kam të ardhme pa ty." Ajo u arrestua sërish në vitin 1982 për lidhjet e saj me disidentë politikë dhe kaloi dy vite në burg, duke përfshirë gati nëntë muaj në izolim. Në burg e mbajtën mes grave të tjera dhe më vonë ajo ka theksuar gjendjen e vështirë të grave të burgosura e artisteve në Iran.

Maryam Rajavi, presidentja e zgjedhur e NCRI-së, ka thënë në një deklaratë se Marjana ishte e spikatur mes grave që janë ngritur dhe kanë luftuar kundër regjimit dhe që janë përfaqësueset të vërteta të vuajtjes së grave iraniane dhe dëshirës së tyre të fuqishme për çlirim. Ajo u largua nga Irani në vitin 2001 dhe shkoi në Dubai.

"Atje shkova në Ambasadën

amerikane dhe u prezantova," pati thënë në një intervistë për Al Arabiya TV më 2015. "Ata mësuuan se isha aktore dhe këngëtare e famshme dhe pranuan të më jepnin azil."

Ajo u vendos në Los Angeles së bashku me të shoqin.

Zëri i Marjanë nuk u dëgjua më në publik deri ë 2005, kur këndoi në Uashington përpara një grupimi të iranianëve të mërguar. Njëra nga këngët në farsi që ajo performoi atë natë shërbeu si thirrje për rezistencë ndaj regjimit klerikal të Iranit: "Degët e mia të reja janë plagosur nga sëpata. Por çfarë do të bëni me rrënjët? Çfarë do të bëni?"

Në një strofë tjetër, ajo thotë që zogjve mund t'u jetë ndaluar të fluturojnë, "por çfarë do të bëni me zogjtë e vegjël në fole?"

Gjatë viteve në vijim, Marjana regjistroi dhe ndihmoi në krijimin e dhjetëra himneve të fuqishme me mesazhe të qarta politike, duke përfshirë "Koha për përmbysje", "Do të ndërtojmë një komb" dhe "Duhet dhe mundemi."

Ajo rrallë herë ka dhënë koncerte

komerciale, pasi ka parapëlqyer të shfaqej në tubime të NCRI-së dhe grupeve të tjera disidente në Shtetet e Bashkuara dhe në Shqipëri, ku banon një komunitet i madh mërgimtarësh iranianë.

Ajo ka performuar në tubimet e përvitshme në Paris përpara turmave që shkonin deri në 100 mijë veta. Në qershor 2018, një tentativë e sponsorizuar nga shteti iranian për të shpërthyer bomba në tubim u parandalua nga autoritetet franceze, gjermane dhe belge të zbatimit të ligjit.

Ndonëse e ndaluar zyrtarisht në Iran, muzika e Marjanës e ka gjetur rrugën drejt një brezi të ri të irrituar nga sundimi represiv i mullahëve.

"Këngët dhe përkushtimi i saj ndaj lirisë dhe popullit të Iranit," tha Rajavi e NCRI-së në një ceremoni në Shqipëri, "janë frymëzuese për të rinjtë e Iranit dhe veçanërisht për gratë e reja e të rebeluara."

Shahla Safi Zamir lindi më 14 korrik 1948 në një familje të pasur në Shiraz të Iranit. Ishte folëse në radio para se të shfaqej në filmin

e parë të saj në 1969-ën, "Një botë plot shpresë," në krah të Mohammad Ali Fardinit, një nga aktorët më të mirënjohur të Iranit.

Marjana aktroi në shumë filma në vitet 1970, shpesh në role disi pikante. Ajo ofroi një performancë veçanërisht dramatike në filmin "Duke u prehur në erë" (1978), me regjisor bashkëshortin e saj, Fereydoun Jourak. Ky ishte filmi i saj i fundit para Revolucionit Iranian.

Martesa e saj e parë, me aktorin e radios Mehdi Ali-Mohammadi, përfundoi në divorc. Ajo ka lënë pas Jourakun, në Los Angeles, një vajzë nga martesa e parë dhe disa nipër e mbesa.

Kur u rishfaq në publik gjatë koncertit të 2005-ës në Uashington, Marjan e lidhi figurativisht rikthimin e saj në skenë me fatin e disidencës iraniane, duke kënduar: "Mos mendoni se jam harruar. Jam gdhendur në histori dhe kujtime. Jam kaq e bashkuar me popullin tim sa që mund të mendoni që jam zëri i tij. Zëri i tij. Zëri i tij." /Burimi: Washington Post/Në shqip: GSh/

E rrallë

“Arrestohet” gomari nën dyshimin për përfshirje në bast

Policia në Pakistan ka arrestuar një gomar, duke e akuzuar se është “përzier” në garën ku njerëzit kishin vënë bast për të. Ky rrëfim bizar ka bërë gjithë botën të qesh, kurse në rrjetet sociale është shpërndarë një video ku shihet një gomar i lidhur para stacionit të policisë, duke pritur ta “marrin në pyetje”. Kjo ngjarje e pazakontë ka ndodhur gjatë javës së kaluar në Pakistan. E policia lokale ka marrë vendim të marrë në pyetje tetë burra nën dyshimin se kanë vënë bast, që konsiderohet krim në këtë vend.



BARSOLETA E DITËS



- Kjo është e tmerrshme, - bërtiti mësuesja.
- Ti Astrit fle gjithë orën e mësimi. Nga do të mësosh ti?
- Në ëndërr po shikoja pikërisht një orë mësimi, mësuese.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje

U dogj në 85% të trupit 53-vjeçares në garë për çmimin ‘Portrait of Humanity 2020’

53-vjeçarja Carol Mayer nga Queensland, Australi, pësoi djegie në rreth 85 përqind të trupit gjatë një zjarri që përfshiu shtëpinë e saj dy dekada më parë. ‘Ish-mbretëresha e bukurisë’, për të cilën u tha që kishte vetëm 50 përqind mundësi për të mbijetuar pas incidentit, ka pozuar disa foto të veçanta. Fotot nudo të shkrepura nga fotografi me origjinë nga Londër, Brian Cassey, dhe që janë titulluar ‘Skin The Skin I’m In’ janë listuar në tabelën për çmimin Portreti ‘Humanity 2020’. Carol dhe djali i saj i mbijetuan flakës së tmerrshme, por Carol

mori plagë që i ndryshuan jetën. Tani, 53 vjeçarja, e cilësuar edhe si ‘ish-mbretëresha e bukurisë thotë’: Me djegiet është e vështirë fizikisht dhe mendë-



isht për çdo njeri që të kalojë. Por nëse e keni atë frymë të vërtetë luftarake, atë që unë kam, kjo është ajo që më ka ripërtëritur, mirësjellje dhe vendosmëri.

FOTO E DITES



Një punëtor i varrezave gërmon një varr të ri në varrezat Xico në periferi të qytetit të Meksikës, pasi shpërthimit të virusit Covid-19. /Reuters/

E jashtëzakonshme

Porositi qafë pulash në dyqan, i erdhi edhe koka e pulës me vete, mbetet e shokuar gruaja në Australi

Një grua nga Australia që bleu qafë pulash për qenin e saj, zbuloi se në paketimin e mishit i kishte ardhur edhe një kokë e pulës. Sipas mediave të huaja, Mersina Vranic u shokua pasi shikoi pamjen e tmerrshme në qesen e pakos. Ajo tha se koka e pulës, të cilën ajo e ka quajtur Phoebe, qëndron ende brenda frigoriferit të saj. “Më erdhi një befasi në paketimin e qafave të pulave këtë mëngjes”, ka shkruar ajo në “Facebook”.



DASHI

Gjatë kësaj dite mund t’ju vijjnë surpriza mjaft të këndshme. Madje ato mund t’jua ndryshojnë edhe kursin e jetë.



DEMI

Mos merrni vendime teksa jeni të përfshirë nga emocionet. Kjo është më se e vërtetë, mbi të gjitha, nëse bëhet fjalë për një projekt të komplikuar.



BINJAKËT

Kjo ditë do të kalojë e qetë. Qëndrueshmëria do të jetë çelësi i fitoreve të reja. Në punë përpuni ta jepni maksimumin tuaj pasi jeni në monitorimin e shefave tuaj.



GAFORRJA

Mos ndani me askënd asnjë prej planeve personale, ideve kreative apo projekteve për biznes. Ka gjasa që dikush t’ju kopjojë, madje edhe qëllimisht.



LUANI

Bëni kujdes me kritikant ndaj njerëzve tuaj të dashur. Mendohuni mirë para se të flisni. Dita do të kalojë shumë më mirë nëse mbani veten nën kontroll.



VIRGJËRËSHA

Kjo e enjte nuk ka gjasa t’ju sjellë mundësinë për t’u relaksuar. Do t’ju duhet gjatë gjithë kohës të nxitoni apo të negocioni për diçka.



PESHORJA

Ekziston mundësia për incidente misterioze. Nuk rekomandohet të bëni një plan strikt për këtë të enjte, pasi rrethanat nuk do t’ju lejojnë ta zbatoni atë.



AKREPI

Të lindurit e kësaj shenje duhet të shmangin egoizmin, mbi të gjitha kur bëhet fjalë për profesionin tuaj. Nuk rekomandohet të ndihmoni dikë duke dalë jashtë kapacitetit tuaj.



SHIGJETARI

Ngjarjet gjatë kësaj dite mund t’ju surprizojnë. Mund të rriteni në detyrë, çfarë do të ndikojë menjëherë në buxhetin tuaj.



BRICJAPI

Ka gjasa të përballeni me probleme si në anën profesionale, ashtu edhe personale. Ata që kanë qëndruar për një kohë të gjatë në një pozicion pune, mund të kërkojnë opsione të reja punësimit.



UJORI

Ekziston mundësia që të përfshiheni në marrëdhënien e dikujt ose të humbisni një shans profesional.



PESHQIT

Do të ndiheni shumë të lodhur gjatë kësaj të enjte dhe nuk do të keni dëshirë për të punuar. Megjithatë, është e nevojshme që t’i kushtoni kohë vetes suaj.

Dafina Zeqiri nis xhirimet e klipit të ri, sjell një tjetër ndryshim në pamje



Para dy ditësh mediat kanë raportuar se ka filluar një bashkëpunim i këngëtares Dafina Zeqiri me reperët Ledri Vula dhe Lumi B. Kënga, e cila tashmë ka filluar xhirimet e klipit, pritet të prezantohet shumë shpejt para publikut.

Lidhur me këtë, artistja e njohur ka sjellë disa pamje nga prapaskenat e videoklipit të ri, duke prezantuar njëherë prej dukjeve të saj në këtë projekt. Meqenëse shquhet për stilin unik, Dafina edhe këtë herë ka eksperimentuar me flokët dhe grimin që ka realizuar.



Anxhelina Hadërgjonaj vjen në formë të mahnitshme në një pozë të re me bikini

Nuk janë të pakta rastet kur këngëtarja Anxhelina Hadërgjonaj merr vëmendje me postimet e saj që herë pas here ndan me fansat. Një gjë të tillë e ka bërë edhe së fundmi,

ndërsa po shijon disa ditë pushimi gjatë qëndrimit të saj në Shqipëri. Ajo ka publikuar një fotografi atraktive në bikini ngjyrë portokalli, teksa ka vënë në pah linjat e mahnitshme.

Djali i madh i Ronados feston ditëlindjen



Të mërkurën ishte një ditë feste në familjen e një prej futbollistëve më të mirë në botë, Cristiano Ronaldos. Djali i tij i madh, Cristiano Ronaldo Junior, festoi ditëlindjen e tij të dhjetë. Përmes një fotoje në rrjetet sociale Ronaldo ka uruar të birin me fjalët

më të ëmbla. "As nuk mund ta besoj se djali im është 10 vjeç. Si kalon koha. Dhe ju keni qenë gjithmonë një burim krenarie për mua, që ju dua aq shumë. Urime vogëlush! Kalofsh një ditë të lumtur! Të dua shumë", ka shkruar Ronaldo në rrjetet sociale.


Menaxheri i grupit 'Babastars' infektohet me Covid-19



Dekorim Sahiti, menaxheri i grupit të njohur shqiptar 'Babastars', ka rezultuar pozitiv me koronavirus. Lajmin e ka bërë me dije vetë ai në një postim në "Facebook", ku shkruan se është vetizoluar dhe është në

gjendje të mirë shëndetësore. Ndër të tjera, Sahiti, i cili ka në pronësi restorantin që ndodhet në "rrugën B" në Prishtinë, ka konfirmuar se i gjithë stafi i tij është testuar por që, fatmirësisht, asnjë nuk ka rezultuar pozitiv.

Leonardo da Vinci: Unë di edhe të pikturoj



Nga Walter ISAACSON

Sapo arriti në atë momentin e padëshiruar të të mbushurit tridhjetë vjeç, Leonardo da Vinci shkroi një letër sundimtarit të Milanos, ku i listonte arsyet përse ai duhet t'i ofronte një vend pune. Ai kishte qenë një piktor pak a shumë i suksesshëm në Firence, por kishte pasur probleme në përfundimin e pikturave që i kishin porositur e tashmë ishte në kërkim të horizonteve të reja. Në dhjetë paragrafët e parë, ai u bëri një përmbledhje dhuntive të tij inxhinierike, përfshirë edhe aftësinë për të ndërtuar ura, kanalizime uji, topa, mjete ushtarake të blinduara dhe godina publike. Vetëm në paragrafin e njëmbëdhjetë, diku nga fundi, ai shtoi se ishte edhe artist. "Sikurse edhe në pikturë, unë mund të bëj gjithçka", – shkroi ai.

Po, ai mund të bënte gjithçka. Ai do krijonte dy pikturat më të famshme të historisë, Darka e fundit dhe Mona Lisa. Por në mendjen e tij ai ishte po kaq i talentuar si njeri i shkencës dhe inxhinierisë. Me një pasion të gjallë, por edhe të fiksuar, ai kreu studime që përbënin risi në anatomi, fosile, zogj, mbi zemrën, makineritë fluturuese, optikën, botanikën, gjeologjinë, rrjedhën e ujit dhe armatimet; duke u bërë kështu prototipi i Njeriut të Rilindjes, një frymëzim për të gjithë ata të cilët besojnë se "veprat e pafundme të natyrës", siç i quante ai, janë të thurura së bashku në një harmoni të mbushur me modele të mrekullueshme. Aftësia e tij për të ndërthurrur artin dhe shkencën, e shndërruar në ikonë përmes vizatimit të tij të një njeriu me përmasa perfekte me krahët hapur brenda një rrethi e katrori, i njohur si Njeriu Vitruvian, e bëri atë gjeniun më krijues të historisë. Zbulimet e tij shkencore e furnizonin me dije artin e tij. Ai rripte lëkurën nga fytyrat e kufomave, analizonte muskujt që kryejnë lëvizjen e buzëve, e më pas pikturoi buzëqeshjen më të paharrueshme të botës. Studioi kafkën njerëzore, bëri vizatime të detajuara të kockave dhe dhëmbëve dhe krijoi agoninë në skeletin e Shën Jeromi në shkretëtirë.

Eksploroi matematikën e optikës, pasqyroj se si rrezet e dritës godasin kornenë e syrit njerëzor, e kështu prodhoi iluzione magjike të ndryshimit të perspektivës

pamore te vepra e tij Darka e fundit. Duke lidhur studimet e dritës dhe optikës me artin e tij, ai u bë mjeshtër i përdorimit të hijes dhe perspektivës për të modeluar objektet në një sipërfaqe dydimensionale, duke i bërë ato të duken si tredimensionale. Kjo aftësi "për ta bërë një sipërfaqe të sheshtë të paraqesë një objekt të modeluar dhe të ndarë nga plani, – tha Leonardo, – ishte synimi parësor i piktorit". Kryesisht për shkak të punës së tij, dimensionin u shndërrua si risia supreme e artit të Rilindjes.

Teksa plakej, ai vazhdoi me zbulimet e tij shkencore jo për t'i shërbyer artit, por i udhëhequr nga një instinkt ngazëllues për të kuptuar sa më mirë bukurinë e thella të natyrës. Kur nisi të studionte teorinë se përse qielli na duket ngjyrë blu, kjo nuk ishte vetëm për të fituar njohuri që të mund t'i përdorte në pikturat e tij. Kurioziteti i tij ishte thjesht një fanatizëm i pastër, personal dhe i bukur.

Por edhe teksta merrej me studimin e qiellit blu, shkenca e tij nuk ishte e ndarë prej artit. Të dyja ato i shërbenin pasionit të tij energjik, që nuk ishte gjë tjetër veçse dëshira për të ditur çdo gjë mbi botën, përfshirë edhe pozicionin që ka njeriu në të. Ai kishte një vlerësim për gjithësinë e natyrës dhe ishte i dashuruar pas harmonisë së modeleve të saj, të cilat i shihte të përsëritura në fenomene të vogla e të mëdha. Në blloqet e tij të shënimeve ai do vizatonte flokë kaçurrela, dallgë uji, vorbullat ajri, bashkë me disa formula matematikore që i shpjegonin të tilla spirale. Në Kështjellën Windsor, teksta po shikoja "Skicat e turbullta" të cilat ai i bëri në prag të fundit të jetës, pyeta kuratorin Martin Clayton nëse mendonte se Leonardo i kishte bërë ato si vepra arti apo studime shkencore. Teksa po flisja, e kuptova vetë që ishte një pyetje pa vend. "Nuk besoj se Leonardo do e kishte bërë dot dallimin", – u përgjigj ai.

Vendosa ta shkruaj këtë libër, pasi Leonardo da Vinci është shembulli i përkryer i tematikës kryesore të biografive të mia të mëparshme: se si aftësia për të lidhur disiplina të ndryshme, si arti dhe shkenca, shkencat shoqërore dhe teknologjia, përbëjnë çelësin e risisë, imagjinatës dhe gjenialitetit. Benjamin Franklin, një figurë që e kam trajtuar në të shkuarën, ishte një Leonardo për epokën e tij: pa asnjë shkollim, ai u vetësimua duke u bërë një dijetar tejet krijues dhe shkencëtar, shpikësi, diplomati, shkrimtari dhe strategu i biznesit, më i miri i iluminizmit në Amerikë. Përmes një balone në fluturim, vërtetoi se vetëtimja është elektricitet dhe shpiku



rufepřitësin për ta zbutur atë. Ai skicoi gjyzykë me dy vatra përqendrimi, instrumente muzikore që të mahnitnin, soba me djegie të pastër, bëri harta të gjirit të detit dhe themeloi stilin e veçantë të humorit amerikan. Albert Einstein, teksta haste vështirësi në studimet e tij mbi teorinë e relativitetit, mernte violinën dhe luante Mozart-in, dhe kjo e ndihmonte të lidhej sërish me harmoninë e kozmosit. Ada Lovelace, së cilës i dedikova një profil në një libër për shpikësit, kombinoi ndjeshmërinë poetike të babait të saj, Lord Byron, me dashurinë e nënës së saj për bukurinë e matematikës, duke hedhur idenë e parë për një kompjuter me funksione të përgjithshme. Dhe Steve Jobs arriti kulmin e shitjeve të produktit të tij përmes një imazhi të shenjave rrugore, ku tregonte ndërthurjen e arteve liberale me teknologjinë. Leonardo ishte heroi i tij. "Ai e shikonte bukurinë si në art ashtu edhe në inxhinieri, – tha Jobs, – dhe aftësia e tij për t'i kombinuar të dyja ishte ajo që e bënte atë një gjeni".

Po, ai ishte gjeni: me një imagjinatë të shfrenuar, kuriozitet të zjarrtë dhe aftësi krijuese në shumë disiplina. Por këtë fjalë duhet ta përdorim me kujdes. Duke i vënë Leonardos etiketën "gjeni", në njëfarë mënyre, ia ulim disi vlerat, pasi e bëjmë të duket sikur ishte i goditur nga rufeja. Biografi i tij i hershëm, Giorgio Vasari, një artist i shekullit të gjashtëmbëdhjetë, e bëri këtë gabim: "Ndodh që, në një mënyrë mbinaryre, një personi të vetëm i dhurohet me bollëk nga qielli bukuria, hir dhe talent aq i madh, saqë çdo vepër e tij është hyjnore dhe çdo gjë që bën duket qartë që vjen nga Perëndia dhe jo nga arti

njerëzor." Në fakt, gjenialiteti i Leonardos ishte njerëzor, i nxitur nga vullneti dhe ambicia e tij. Nuk vinte si dhuartë hyjnore, ashtu si Newton apo Einstein, të cilët kishin një mendje me një fuqi aq të madhe funksionale, saqë ne njerëzit e thjeshtë nuk mund ta kuptojmë. Leonardo pothuajse ishte pa shkollë dhe me vështirësi arrinte të lexonte latinisht apo të bënte përlllogaritje matematikore disashifrore. Gjenialiteti i tij i përkiste një lloji të cilin ne mund ta kuptojmë, madje edhe ta përdorim si shembull. Ishte i bazuar mbi aftësi të cilat ne mund të aspirojmë që t'i arrijmë te vetja jonë, si, për shembull, kurioziteti dhe vëzhgimi intensiv. Ai kishte një imagjinatë aq joshëse e cila lodronte me skajet e fantazisë, gjë që edhe ne duhet të përpiqemi ta ruajmë te vetja jonë dhe duhet t'ua pasojmë edhe fëmijëve tanë.

Fantazitë e Leonardos shpaloseshin në çdo gjë që ai prekte: shfaqje teatrale, planet për ndryshimin e rrjedhës së ujit, skica për qytetet ideale, skema për makineri fluturuese dhe pothuajse çdo aspekt tjetër i artit të tij dhe inxhinierisë. Letra e tij drejtuar sundimtarit të Milanos është një shembull i mirë për këtë, pasi aftësitë e tij mbi inxhinierinë ushtarake vetëm sa i kishte në mendje. Roli i tij i parë në oborrin e sundimtarit nuk ishte për ndërtimin e armëve, por për të organizuar festivale e parada. Edhe në kulmin e karrierës së tij, shumica e makinerive të tij luftuese apo fluturuese ishin më shumë vizionare sesa praktike.


Në fillim unë mendova se ndjeshmëria e tij ndaj fantazisë ishte një dështim, që shpaloset në mungesën e disiplinës dhe zellit, dhe në prirjen për të lënë përgjysmë vepra arti apo duke

lënë pa përfunduar studime të ndryshme. Vizioni pa zbatueshmërinë është vetëm një iluzion. Por unë zbulova se aftësia e tij për të zbutur vijën ndarëse midis realitetit dhe fantazisë, ashtu si edhe teknika e sfumaturës për zbutjen e vijave në pikturë, ishte çelësi i krijimtarisë së tij. Aftësia pa imagjinatë është shterpë. Leonardo dinte si të mblesëronte vëzhgimin me imagjinatën, ndaj edhe mbetet novatori më i madh i historisë.

Pikënisja ime për këtë libër nuk ishin kryeveprat artistike të Leonardos, por blloqet e tij të shënimeve. Unë mendoj se mendja e tij shpaloset më mirë te mbi 7.200 faqet e blloqeve dhe shënimeve të tij, të cilat, për mrekulli, mbijetuan deri në ditët e sotme. Na doli që letra qenka një teknologji e jashtëzakonshme e ruajtjes së informacionit, e lexueshme edhe pas pesëqind vitesh, gjë që është e vështirë të thuhet për shënimet tona në rrjetet sociale.

Fatmirësisht, Leonardos nuk ia mbante xhepi ta shpërdoronte letrën, kështu ai mbushi çdo cep të faqes me vizatime të shumëllojshme dhe me shënime të vogla për t'u lexuar me lupë, të cilat duken të zakonshme, por na japin informacion mbi ecurinë e mendjes së tij. Të shkarravitura krahu njëra-tjetër, pa lidhje midis tyre, gjenden përlllogaritje matematikore, vizatime të dashurisë të tij të ri mistrec, zogj, makineri fluturuese, zburime teatri, valë deti, valvulat e gjakut, koka groteske, engjëj, sifone, kërcëj bimësh, kafka të prera, këshilla për piktorët, shënime për syrin dhe optikën, armë lufte, fabula, gjëgjëza dhe studime për piktura. Madhështia ndërdisiplinore shpaloset në çdo faqe, duke na

ofruar një pamje të mrekullueshme të një mendjeje që vallëzon me natyrën. Bllloqet e tij të shënimeve janë të dhënat më të mëdha që ka krijuar ndonjëherë kurioziteti njerëzor, një guidë mahnitëse e njeriut të cilin historiani i shquar i artit Kenneth Clark e quajti “mendja me



kuriozitetin më të pakapërcyeshëm të historisë”. Perlat e mia të preferuara në bllloqet e tij të shënimeve janë listat e gjërave që planifikon të bëjë. Njëra prej tyre, e cila daton në vitet 1490 në Milano, është lista e gjërave që dëshiron të mësojë për atë ditë. “Matja e Milanos dhe rrethinave të qytetit” është e para në listë. Kjo ka një qëllim praktik, pasi shpjegohet nga një shënim tjetër në listë: “Vizato Milanon.” Shënimet e tjera tregojnë që ai kërkonte me këmbëngulje të gjente njerëz të tjerë që t’i mësonin gjërat që ai nuk i dinte: “Gjej mjeshttrin e aritmetikës të mësojë se si të sheshosh një trekëndësh... Pyet Giannino bombarduesin sesi është e rrethuar kulla e Ferraris... Pyet Benedetto Protiniari-n sesi arrijnë të ecin mbi akull flemingët në zonat e ulëta... Gjej mjeshttrin e hidraulikëve të mësojë sesi të riparosh një grup, një kanal dhe një mull sipas mënyrës në Lombardi... Gjej përmasat e diellit siç të ka premtuar mjeshtër Giovanni Francezi, të cilin e thërrasin Francezi.” Ai është i pangopur për dije. Herë pas here, vit pas viti, Leonardo liston gjërat që duhet të bëjë apo mësojë. Disa prej tyre kanë të bëjnë me studime të detajuara, të cilat neve as që na shkon në mendje t’i bëjmë. “Studio këmbën e patës: nëse do ishte gjithmonë e hapur ose gjithmonë e mbyllur, shpendi nuk do ishte në gjendje të bënte as edhe një lëvizje.” Të tjerat kanë të bëjnë me pyetje, si përse është qielli blu apo fenomene aq të zakonshme, saqë neve as na shkon në mendje t’i mendojmë. “Përse peshku në ujë është më i shpejtë sesa zogu në ajër, kur


duhet të jetë e kundërta, duke qenë se uji është më i rëndë dhe më i trashë sesa ajri?”

Më të mirat janë ato pyetjet të cilat duket se janë tërësisht të rastësishme. “Përshkruaj gjuhën e qukapikut”, – udhëzoni ai veten. E kujt në këtë botë do t’i shkrepse në mendje që një ditë, pa as edhe një arsye, do donte të dinte se ç’pamje ka gjuha e qukapikut? E si do ta zbulosh këtë? Dhe nuk është as informacion që Leonardos i duhej për të pikturuar një tablo apo për të kuptuar fluturimin e zogjve. Por ja që është në ato shënime dhe siç do e shohim më vonë, ka gjëra të mrekullueshme që mund të mësojmë për gjuhën e qukapikut. Por arsyeja kryesore përse ai donte ta dinte ishte sepse ai ishte Leonardo: kurioz, pasionant dhe gjithnjë i mbushur me habi.

Por më i çuditshmi është ky shënim: “Shko çdo të shtunë te banja e nxehtë ku do shohësh burra lakuriq.” Arrijmë ta imagjinojmë Leonardon duke e bërë këtë, për arsye anatomike dhe estetike. Por a duhej ta kujtonte veten që të shkonte e ta bënte këtë? Tjetra në listë është: “Fry mushkëritë e derrit dhe vëzhgo nëse zgjerohen në gjerësi dhe gjatësi, apo vetëm në gjerësi.” Ashtu siç shkroi kritiku i artit për New Yorker, Adam Gopnik, “Leonardo mbetet i çuditshëm, më i çuditshëm s’ka ku të vejë, dhe nuk kemi se çfarë t’i bëjmë këtij fakti”.


Për t’i shtjelluar këto çështje, vendosa të shkruaj një libër që të bazohej kryesisht mbi këto bllloqe shënimesh. Nisa me pelegrinazhet e mia për të parë originalet në Milano, Firenze, Paris, Siatell, Madrid, Londër dhe në Kështjellën Windsor. Ky ishte zbatim i urdhrit të Leonardos që për të nisur një studim, duhet të shkosh te burimi: “Ai që mund të shkojë te burimi i ujit, nuk shkon te brokja me ujë.” Gjithashtu u zhyta në pargun e artikujve shkencorë dhe disertacionet doktorale mbi Leonardon, ku secili prej tyre përmban vite të tëra pune për tema të caktuara. Gjatë dekadave të fundit, sidomos që nga zbulimi në vitin 1965 i shënimeve të tij, që njihen si Kodikët Madrid, ka pasur shumë përparime në analizimin dhe interpretimin e shkrimeve të tij. Gjithashtu, teknologjia moderne na ka zbuluar informacione të reja mbi pikturat e tij dhe teknikat që përdorte.

Pasi u angazhova i tëri me Leonardon, bëra aq sa munda që të isha më vëzhgues ndaj fenomeneve të cilat më parë i injoroja, duke u përpjekur që t’i shikoja gjërat ashtu siç i shikonte ai. Kur pashë dritën e diellit që përplasej te perdet, e binda veten të ndaloja e të shikoja se si hijet përkëdhelnin palat. U përpoqa të shoh se si drita e reflektuar nga një objekt ngjyrose me delikatesë hijet e një objekti tjetër. Vura re se si shkëlqimi i një pike të shndritshme mbi një sipërfaqe të lëmuar lëvizte kur unë tundja kokën. Kur shikoja një pemë larg e një tjetër më pranë meje, përpiquesha të krijoja imazhin e



linjave të perspektivës. Kur pashë një spirale uji, e krahasova me flokët kaçurrela. Kur nuk e kuptoja dot një koncept matematikor, përpiquesha sa të mundja ta imagjinoja si një figurë. Kur shikoja njerëz që darkonin së bashku, studiova marrëdhënien midis lëvizjeve dhe emocioneve të tyre. Kur pashë lindjen e një buzëqeshjeje në buzët e dikujt, u përpoqa të kuptoja misteret e brendshme të njeriut.

Jo, as që iu afrova Leonardos, as të kuptoja si ai e as të fitoja ndonjë talent sado të vogël me talentin e tij. As që iu afrova qoftë edhe një milimetër aftësisë për të skicuar një makinë fluturuese, të shpikja një mënyrë të re për të bërë harta, apo të pikturoja Mona Lisën. E forcova veten e me detyrim u bëra kurioz për gjuhën e qukapikut. Por mësova nga Leonardo se si dëshira për t’u mahnitur me botën që ne hasim çdo ditë mund ta bëjë më të pasur çdo moment të jetës sonë. Ka tre dëshmi madhore mbi Leonardon nga shkrimtarë të cilët pothuajse ishin bashkëkohësit e tij. Piktori Giorgio Vasari, i lindur në vitin 1511 (tetë vite përpara se të vdiste Leonardo), shkroi librin e parë të vërtetë mbi historinë e artit, Jetët e piktoreve, skulptoreve dhe arkitektëve më të shquar, i botuar në vitin 1550, dhe u ribotua në vitin 1568 me korrigjime të bazuara mbi intervista të tjera me njerëz të cilët e njihnin Leonardon, përfshi edhe nxënësin e tij Francesco Melzi. Një shovinist florentin, Vasari i përkuشتoi Leonardos, sidomos Mikelanxhelos, respektin më të plotë për krijimin e asaj që ai e quajti, për herë të parë e shkruar në letër, një “rilindje” në art. Ashtu siç Huckleberry Finn tha për Mark Twain, kishte gjëra që Vasari i



Njeriu Vitruvian, rreth 1490

ekzagjeroi paksa, por në të shumtën e rasteve tha të vërtetën. Ajo që na mbetet është një përzierje thashethemesh, zbulurimesh, sajesash dhe gabimesh të paqëllimshme. Problemi qëndron se në cilën prej tyre hyjnë ato anekdotat aq piktoreske – si për shembull, ajo e mësuesit të Leonardos që e hodhi penelin e vet kur pa talentin e nxënësit të tij.

Dorëshkrimi anonim i shkruar gjatë viteve 1540, i njohur si “Anonimo Gaddiano”, sipas emrit të familjes që e zotëronte dikur, përmban detaje shumëngjyrëshe mbi Leonardon dhe florentinë të tjerë. Edhe këtu, disa prej pohimeve në këtë dorëshkrim, si, për shembull, Leonardo jetoi dhe punoi me Lorenzo de’Medici, mund të jetë e zbuluar, por na jep detaje interesante që tingëllojnë të vërteta. Për shembull, Leonardos i pëlqente të vishte tunikë ngjyrë rozë e cila i varej deri te gjunjët, ndonëse të tjerët vishnin troba të gjata.

Burimi i tretë i hershëm është nga Gian Paolo Lomazzo, një piktor i cili u bë shkrimtar e më pas u verbua. Rreth vitit 1560 ai shkroi një dorëshkrim të titulluar Ëndrrat dhe argumentet i cili u botua më vonë në vitin 1584 si një tekst voluminoz mbi artin. Ai ishte nxënësi i një piktori i cili e kishte njohur Leonardon dhe ai intervistoi Melzin, nxënësin e Leonardos, duke bërë kështu të kishte informacion të dorës së parë mbi historitë e mjeshtrit. Lomazzo zbulon shumë të dhëna mbi prirjet seksuale të Leonardos. Për më tepër, ka edhe dorëshkrime të tjera më të shkurtra prej dy bashkëkohësve të Leonardos, Antonio Billi, një tregtar florentin, dhe Paolo Giovio, një mjek dhe historian italian. Shumë prej këtyre dokumenteve të hershme përmendin pamjen dhe personalitetin e Leonardos. Ai përshkruhet si një njeri i pashëm dhe i hirshëm. Kishte kaçurrela të derdhura dhe të arta, një trup muskuloz, një forcë fizike të admirueshme dhe një elegancë në sjellje teksa shëtiste nëpër qytet me veshjen e tij shumëngjyrëshe apo kur ngiste kalin. “I bukur në pamje dhe në personalitet, Leonardo ishte tërheqës dhe plot hir”, – shkruhet në dorëshkrimin e Anonimo-s. Për më tepër, ai ishte një bashkëbisedues tejet tërheqës dhe i dashuruar pas natyrës, i njohur si njeri i ëmbël dhe i dashur si me njerëzit ashtu edhe me kafshët.

Ka më pak pajtueshmëri për disa specifika të veçanta. Gjatë studimit tim zbulova se shumë fakte mbi jetën e Leonardos, që nga lindja e deri te vdekja e tij, kanë qenë temë debati, miti dhe misteri. Do përpiqem të jap vlerësimin tim më të mirë e të përshkruaj polemikat dhe kundërgjënimet përmes shënimeve.

Gjithashtu zbulova, si fillim u shtanga, por më pas e pashë si kënaqësi, që Leonardo nuk ishte gjithmonë një gjigant. Ai bënte gabime. Merrej me gjëra pa lidhje, sinqerisht e kam, ndiqte probleme

matematikore që vetëm sa ia çonin kohën dëm. Fatkeqësisht, shumë prej pikturave të tij i la pa përfunduar, në veçanti Adhurimi i mbretit, Shën Jeromi në shkretëtirë dhe Beteja e Anghiari-t. Kësisoj, sot kemi vetëm pesëmbëdhjetë piktura që i atribuohen plotësisht apo pjesërisht atij.

Ndonëse në përgjithësi ai konsiderohej nga bashkëkohësit e tij si miqësor dhe i sjellshëm, kishte raste kur Leonardo ishte i zymtë dhe i trazuar. Shënimet dhe vizatimet e tij janë dritare e qartë e mendjes së tij eksituese, imagjinare, maniake, e me raste, edhe e ngazëllyer. Nëse do kishte qenë student në fillim të shekullit të njëzetë e një, do i kishin dhënë një recetë me ilaçe për të stabilizuar luhatjet e humorit dhe çrregullimin e mungesës së vëmendjes. Askush nuk duhet t’u bashkohet opinionistëve të cilët e konsiderojnë atë si një artist gjeni të trazuar, për të besuar se ne jemi me fat që Leonardo ishte i lirë të përdorte veset e tij për të masakruar demonët e tij e për të zgjuar dragonjtë.

Në një nga gjëgjëzat në bllloqet e tij të shënimeve gjendet kjo e dhënë: “Figura të mëdha do shfaqen në formën njerëzore dhe sa më shumë t’i afroresh, aq më shumë përmasat e tyre të stërmëdha do zvogëlohen.” Përgjigjja është kjo: “Hija e njeriut gjatë natës me një dritë.” Ndonëse e njëjta gjë mund të thuhet për Leonardon, në fakt, unë besoj se ai nuk zvogëlohet nëse zbulohet se është njeri. Si hija, ashtu edhe realiteti i tij, meritojnë të shihen si madhështore. Gabimet dhe sjelljet e tij të çuditshme na bëjnë që edhe ne të identifikohemi me të, të ndihemi se edhe ne mund të matemi me të dhe t’i vlerësojmë edhe më shumë momentet e triumfit të tij.

Shekulli i pesëmbëdhjetë i Leonardos, Columbus dhe Gutenberg, ishte koha e novacionit, e zbulimit dhe përhapjes së dijes përmes teknologjive të reja. Thënë shkurt, ishte një kohë si kjo e jona. Ndaj edhe ne kemi shumë për të mësuar nga Leonardo. Aftësia e tij për të ndërthurr artin, shkencën, teknologjinë dhe imagjinatën mbetet një recetë e përjetshme për krijimtarinë. Kështu ishte edhe stili i tij i jetesës, paksa mospërputhës me shoqërinë: i kundërligjshëm, homoseksual, vegetarian, mëngjarash, i shpërgjenduar, me raste edhe heretik. Firenze lulëzoi gjatë shekullit të pesëmbëdhjetë, sepse ishte komode me njerëz të tillë. Mbi të gjitha, kurioziteti i pashteruar i Leonardos dhe eksperimentet e tij duhet të na kujtojnë rëndësinë e bindjes, si për veten ashtu edhe për fëmijët tanë, që të mos marrin thjesht dije, por të jemi të vullnetshëm ta analizojmë atë – të jemi krijues dhe si njerëz të talentuar, mospërputhës dhe rebelë të çdo epoke, të mendojmë ndryshe.

Për ta blerë:
<https://onufri.com/bli/leonardo-da-vinci/>
(Exlibris, Përkthyer nga Bledar Kurti)

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Selimi, trajneri më i ri që fitoi trofe: Ishin ndjenja të papërshkrueshme. Nuk i harroj kurrë



“Ka qenë ndjenjë e papërshkrueshme, edhe pse kanë kaluar shumë vite. Ai sukses mbetet ndër çastet më të mira në karrierën time. Loja ka qenë shumë interesante dhe në fund arritëm ta mposhtim Besianën me rezultat 1-0. Në të njëjtin vit e fituam edhe Superkupën ndaj Prishtinës (4-1)”, ka thënë Selimi

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Trajneri i futbollit në Kosovë, Musa Selimi, është trajneri më i ri në futbollin e Kosovës që ka arritur të fitojë trofe. Selimi në moshën 32 vjeçe i ka prirë skuadrës së Gjilanit drejt një suksesi të madh, duke e fituar Kupën e Kosovës. Trajneri gjilanas të enjten në bisedë për “Epokën e re” ka thënë se ato çaste mbetën ndër më të mirat në jetën e tij dhe se do t'i kujtojë përherë. “Ka qenë ndjenjë e

papërshkrueshme, edhe pse kanë kaluar shumë vite. Ai sukses mbetet ndër çastet më të mira në karrierën time. Loja ka qenë shumë interesante dhe në fund arritëm ta mposhtim Besianën me rezultat 1-0. Në të njëjtin vit e fituam edhe Superkupën ndaj Prishtinës (4-1)”, ka thënë Selimi, i cili më pas me plot sukses ka drejtuar shumë klube në futbollin e Kosovës dhe sukseset kanë qenë të mëdha. “Profa” e ka analizuar edhe finalen e Kupës për këtë edicion në mes të Ballkanit dhe Prishtinës. Ai ka thënë se cilado

skuadër që e fiton trofeun e ka më se të merituar. “Do të jetë një finale interesante, pasi përballen dy ekipe shumë mira të komponura dhe me lojtarë fantastikë. Do të jetë ndeshje e vështirë për të dyja klubet, por cilado që e fiton trofeun mund të them se e meriton”, ka deklaruar ai për “Epokën e re”. Aktualisht Musa Selimi është duke i munguar futbollit, por jo edhe sportit të Kosovës. Ai me shumë sukses është duke e kryer detyrën e dekanit në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit, kurse është edhe kryetar i Federatës së Sportit Universitar të Kosovës.

Gashi: Besa do ta hijeshojë Superligën

Mesfushori Dugagjin Gashi është i bindur se skuadra e Besës do t'i japë hijeshi Superligës në edicionin 2020/2021. “Nuk e di se çfarë synime do të ketë klubi i Besës në edicionin e ri në Superligë pasi kjo varet nga pronari i klubit. Besoj shumë se Besa do t'i japë hijeshi Superligës dhe do të jetë një klub stabil”, ka thënë Gashi



pasi kjo varet nga pronari i klubit. Besoj shumë se Besa do t'i japë hijeshi Superligës dhe do të jetë një klub stabil”, ka thënë Gashi.

Kontrata e mesfushorit me skuadrën e Besës është e vlefshme deri në fund të këtij muaj, kurse shumë shpejt do të zhvillohen bisedimet për zgjatjen e saj. Futbollisti pejan ka bërë me dije se është shumë i interesuar që edhe sezonin tjetër të luajë për klubin e tij të zëmërës. “Normalisht se jam i gatshëm të vazhdoj kontratën me Besën, sepse është klubi i vendlindjes sime dhe me të i kam arritur sukseset më të mëdha si futbollist. Kam qenë pjesë e rrugëtimit drejt rikthimit në Superligë dhe dua që të vazhdoj këtë rrugëtim”, ka shtuar Gashi.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Skuadra e Besës së Pejës e arriti një sukses të madh, pasi është rikthyer pas dy vjetësh në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Në fakt, klubi me traditë të madhe në futbollin e Kosovës ishte lider në Ligën e Parë, kur Federata e Futbollit mori vendim për pezullimin e

kampionatit në këtë rang garash për shkak të pandemisë Covid-19.

Në këtë mënyrë Besa dhe Arbëria në edicionin e ardhshëm do të jenë pjesë e elitës. Mesfushori me përvojë të madhe në futbollin vendor, Dugagjin Gashi, ka thënë të enjten për “Epokën e re” se skuadra pejane është rikthyer me plot meritë në Superligë.

“Besoj shumë se me meritë jemi rikthyer në Superligë, pasi nga fillimi kemi qenë në pozitën e parë. Kemi pasur ekip stabil dhe kushtet i kemi pasur të mira falë Shkumbin Gashit dhe ‘Elkos

Gruop”, ka thënë ai. Më pas mesfushori ka folur edhe për synimet që mund të ketë klubi i Besës. “Nuk e di se çfarë synime do të ketë klubi i Besës në edicionin e ri në Superligë,

Hidhet shorti për gjysmëfinalet e Kupës në hendboll

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Në gjysmëfinale të garave për Kupën e Republikës së Kosovës në konkurrencë të meshkujve do të kemi përsëritje të ndeshjeve gjysmëfinale të plejofit. Shorti i

tërhequr sot në mesditë ka caktuar që Kastrioti të takohet me Besa Famgas, ndërsa Trepça me Prishtinën. Ndashjet gjysmëfinale të Kupës luhen më 27 qershor, kurse finalja më 28 qershor. Ndashjet

luhen në Prishtinë duke respektuar masat dhe rekomandimet në luftë ndaj përhapjes së Covid-19. Ndashjet në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve luhen pa praninë e shikuesve. Të enjten në mesditë

është tërhequr shorti edhe për ndeshjet gjysmëfinale të Kupës në konkurrencë të femrave, ku do të takohen Istogu me Kastriotin dhe Vushtrria me Prishtinën. Ndashjet gjysmëfinale luhen më 27 qershor,

kurse finalja më 28 qershor. Të gjitha ndeshjet luhen në Pallatin e Rinisë në Prishtinë, pa praninë e shikuesve dhe duke respektuar masat dhe rekomandimet për përballje me COVID-19.

Drita sot kërkon fitore ndaj Ferizajt

Gjilan, 18 qershor - Skuadra e Dritës, e cila është lidere e IPKO Superligës së Kosovës në futboll, sot (e premte) kërkon fitore nga ndeshja kundër Ferizajt, e cila është e vlefshme për javën e 25-

të. Klubi nga Gjilani kërkon që të marrë tri pikë të plota nga kjo sfidë në mënyrë që ta ruajë pozitën e parë dhe t'i ofrohet edhe më shumë titullit të kampionit

në elitë, derisa Ferizaj do të mundohet që nga kjo ndeshje të dalë me pikë dhe të ëndërrojë për mbijetesë. Tri ndeshje do të zhvillohen të shtunën, ku do të takohen:

Drenica-Flamurtari, Prishtina-Dukagjini dhe Gjilani-Vushtrria. Ndërsa kjo xhiro mbyllet të dielën me dy ndeshjet që fillojnë nga ora 17:00, Ballkani-Trepça'89 dhe Feronikeli-Llapi.




Werner: Mezi pres fillimin e sezonit të ri

LONDËR, 18 QERSHOR - Skuadra e Chelsea edhe zyrtarisht e ka transferuar sulmuesin Timo Werner nga RB Leipzig. Sulmuesi i reprezentacionit gjerman do të nënshkruajë kontratë pesëvjeçare me klubin anglez, derisa Chelsea do

t'i paguajë Leipzig 50 milionë euro. Werner do t'i fitojë plot 10 milionë euro në vit në Angli. Werner është shfaqur shumë i lumtur që do t'i bashkohet klubit anglez, kurse e ka falënderuar RB Leipzigun dhe tifozët për vitet

e kaluara së bashku. "Jam i lumtur që po nënshkruaj për Chelsea. Është një moment shumë krenar për mua që po bashkohem me këtë klub të shkëlqyeshëm. Sigurisht se dua të falënderoj RB Leipzigun, klubin dhe tifozët,

për katër vjet fantastike. Do të jenë përgjithmonë në zemrën time", ka thënë Werner. "Mezi po pres sezonin e ardhshëm me shokët e mi të ri të ekipit, menaxherin tim të ri dhe natyrisht tifozët e Chelsea. Së bashku kemi një të ardhme



shumë të suksesshme përparanesh", ka deklaruar Werner.

FIBA Evropa vendos për datat e kampionateve evropiane



Prishtinë, 18 qershor - Bordi i FIBA Evropës ka vendosur për datat e sakta të FIBA Kampionateve Evropiane të vitit 2021. Sipas vendimit të Bordit të FIBA Evropës të datës 7 prill 2020, të gjithë organizatorët e vitit 2020 kanë të drejtë të organizojnë eventin edhe në 2021-n nëse dëshirojnë dhe kanë mundësi ta bëjnë një gjë të tillë. Me këtë rast FIBA Evropa ka kërkuar nga të gjitha shtetet organizatore të eventeve të vitit 2020 ta informojnë FIBA-n më së largu më 21 gusht 2020 nëse ata dëshirojnë apo nuk dëshirojnë të organizojnë të njëjtin event edhe më 2021. Regjistrimi i shteteve për pjesëmarrje në FIBA Kampionate Evropiane do të bëhet si zakonisht, pra ndërmjet muajve shtator/tetor 2020. FIBA Evropa ka kërkuar nga të gjitha Federatat Nacionale që t'i regjistrojnë ekipet e tyre për vitin 2021, pasi regjistrimet e paraqitura për vitin 2020 nuk do të merren parasysh. Duhet theksuar se Federata e Basketbollit e Kosovës ka qenë organizatore e FIBA U16 Kampionatit Evropian, Divizioni C, në Prishtinë, prej 11 deri më 19 korrik 2020, por në prill të këtij viti, për shkak të përhapjes së pandemisë COVID-19, FIBA Evropa i anuloi të gjitha eventet. Në vitin 2020 FBK-ja i kishte paraqitur pesë përfaqësues për të garuar në FIBA Kampionate Evropiane: Kosova U16 meshkujt, Kosova U18 meshkujt, Kosova U20 meshkujt, Kosova U16 femrat dhe Kosova U20 femrat. Përveç Kosovës U16 meshkujt që garon në Divizion C të gjitha të tjerat garojnë në Divizion B. Sa i përket FBK-së, nëse do të jetë organizatore e FIBA U16 Kampionatit Evropian, Divizioni

C - Meshkujt në vitin 2021, si dhe për ekipet përfaqësuese me të cilat pritet të paraqitet në vitin 2021, sekretarja e përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku, ka deklaruar se në parim FBK-ja është e interesuar për të organizuar FIBA U16 Kampionatin Evropian, Divizioni C, në Prishtinë, në vitin 2021, por ende nuk mund të marrim një vendim përfundimtar pasi ende është përmirësuar situata nga dëmet e shkaktuara me rastin e përhapjes së pandemisë Covid-19. "Bordi i FBK-së në mbledhjen e radhës ndër temat e rendit të ditës pritet ta diskutojë edhe këtë çështje dhe më pas, në muajin gusht, duhet ta marrim një vendim përfundimtar dhe ta njoftojmë FIBA Evropën për cilindo vendim. Do të ishte mirë për FBK-në dhe për Kosovën në përgjithësi që ne të jemi organizatorë të një eventit të tillë, kur dihet se kjo i sjellë përfitime edhe shtetit të Kosovës

në përgjithësi. Ndërkaq sa i përket ekipeve përfaqësuese me të cilat pritet të garojmë në vitin e ardhshëm, ne besoj se do të vazhdojmë me të tri ekipet në konkurrencën e meshkujve, ndërsa të femrat ende jemi në fazën e diskutimeve, pasi që kemi interesim edhe për paraqitje të Përfaqësueses A të Femrave për herë të parë në gara ndërkombëtare, e kësaj radhe bëhet fjalë për FIBA Kampionatin Evropian të Shteteve të Vogla. Në fakt, ky ka qenë vetëm një diskutim ndërmjet kryetarit të FBK-së, sekretares së përgjithshme dhe drejtorit të përfaqësueseve. Do të ishte mirë të realizohet një gjë e tillë, por se për ta bërë një gjë të tillë ne kemi nevojë për një mobilizim më të madh pasi bëhet fjalë për Përfaqësuesen A dhe kërkon vëmendje dhe përkrahje më të madhe si nga opinioni basketbolldashës ashtu edhe nga shteti", ka thënë Dushku.

DATAT E FIBA KAMPIONATEVE EVROPIANE TË VITIT 2021:

FIBA U16 European Championship	(13-21 gusht 2021)
FIBA U16 European Championship Div .B	(13-21 gusht 2021)
FIBA U16 European Championship Div .C	(13-18 korrik 2021)
FIBA U18 European Championship	(31 korrik-8 gusht 2021)
FIBA U18 European Championship Div. B	(31 korrik-8 gusht 2021)
FIBA U18 European Championship Div.C	(27 korrik-1 gusht 2021)
FIBA U20 European Championship	(17- 25 korrik 2021)
FIBA U20 European Championship Div. B	(17-25 korrik 2021)
FIBA U16 Women's European Championship	(6-14 gusht 2021)
FIBA U16 Women's European Championship Div. B	(6-14 gusht 2021)
FIBA U16 Women's European Championship Div. C	(13-18 korrik 2021)
FIBA U18 Women's European Championship	(24 korrik-1 gusht 2021)
FIBA U18 Women's European Championship Div. B	(24 korrik-1 gusht 2021)
FIBA U18 Women's European Championship Div. C	(27 korrik-1 gusht 2021)
FIBA U20 Women's European Championship	(3-11 korrik 2021)
FIBA U20 Women's European Championship Div. B	(3-11 Korrik 2021)
FIBA European Championship për Shtete të Vogla	(28 qershor-3 korrik 2021)
FIBA Women's European Championship për Shtete të Vogla	(15 qershor-20 Qershor 2021)

SHKURT

Shatri do të vrapoj nga Prishtina në Tiranë

Ish-basketbollisti dhe trajneri i njohur i basketbollit, Fikret Shatri, po planifikon të thyejë edhe një rekord në vrapim. Shatri nëpërmjet një postimi në profilin e vet në "Facebook" ka bërë me dije se më 2 korrik do të nisët nga Prishtina për të vazhduar me vrapim deri në Tiranë. "Edhe 15 ditë... Prishtinë - Tiranë 257 km. Vrap i shqipes nga Skënderbeu në Skënderbe. Më 2 korrik nga ora 18:00", ka shkruar Shatri, i cili ditë më parë ka vrapuar nga Prishtina në vendlindjen e tij, Istog.

Sarri: Zhgënjyes dështimi në finale të Kupës

Skuadra e Juventusit humbi pas penalltive në finale të Kupës së Italisë nga Napoli. Këtë dështim trajneri i "Zonjës së Vjetër", Maurizio Sarri, e ka quajtur zhgënjim të madh për klubin, lojtarët dhe tifozët. "Ka trishtim, zhgënjim, për lojtarët, për shoqërinë, mbi të gjitha për tifozët. Zhvilluam një ndeshje ndryshe, nuk ishim agresivë, por lojtarët u treguan të zotë në nivel taktik, i lejuam pak raste kundërshtarit. Në këto çaste na mungon freskia fizike, pra na duhet të punojmë më shumë për të zgjidhur këtë problem", ka thënë Sarri.

Gattuso: Jeta të merr diçka, por futbollit më ka dhënë shumë

Gennaro Gattuso pas triumfit në Kupën e Italisë 2019/2020 ishte mjaft i emocionuar për faktin se ky trofe ishte i parë për të si trajner. Trajneri italian ka thënë se beson se në futboll është një Zot, i cili ta kthen atë që të takon. "Kur ndodh ajo që më ndodhi mua, jeta të merr diçka (motrën), por futbollit më ka dhënë shumë, ndoshta edhe më shumë nga sa i kam dhënë unë. Besoj se ka një Zot të futbollit, që kur punon shumë të kthen atë që të takon. Kam folur me djemtë, sepse kush bën këtë profesion duhet ta bëjë me respekt. Unë dua njerëz që të vënë pasionin në lojë, si kam bërë unë për shumë vjet", ka thënë Gattuso.

Messi nuk do të largohet nga Barcelona

Ylli i Barcelonës, Lionel Messi, nuk e ka ndërmend të largohet nga skuadra katalanase, pasi shumë shpejt pritet të nënshkruajë kontratë të re. "Mundo Deportivo" raportoi se Messi do ta vazhdojë kontratën deri në vitin 2023. Në kontratën e re, Messi do të ketë kushte të njëjta financiare, por do të vendosë klauzolë që ia mundëson largimin edhe më herët nga "Camp Nou", nëse dëshiron. Është raportuar më herët se Messi mund ta braktisë Barcelonën, pas polemikave që ka pasur me drejtorin sportiv Erik Abidal. Këtë sezon me Barçën, ai ka shënuar 21 gola në La Liga dhe është shënuesi më i mirë.

Nani: Ronaldo mund të pensionohet në Amerikë

Ende nuk dihet se në cilën skuadër do të pensionohet Cristiano Ronaldo. Futbollisti i Orlando Cityt në Amerikë, Luis Nani, që ka luajtur bashkë me Ronaldon në Manchester United dhe Kombëtaren e Portugalisë, ka thënë se ylli aktual i Juventusit mund të pensionohet në Amerikë. "Para disa vitesh ai më ka thënë që ndoshta do ta mbyllë karrierën duke luajtur në Amerikë. Nuk është 100 % i sigurt, por ekziston mundësia që të ndodhë", ka deklaruar Ronaldo.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Komuna Dragash/Opštine Dragaš / Daragas Municipality

Dt.19/06/2020

Në bazë të nenit 8 paragrafi 1. Dhe 2. të Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës Nr.03/L-212, kërkesës së drejtorit të QKMF Dragash me nr.02.111/03-6226/20 dt.13/05/2020,aprovimit nga kryetari i Komunes së Dragash-it Shërbimi I Personelit K.Dragash shpallë:

KONKURS

për Komunitete

- Vendi i Punës;Punëtor teknik-Pastrues në QKMF,QMF dhe AMF-Dragash
- Vendi i Punës;Punëtor teknik-Pastrues në ;QMF Krusev-Dragash
- Niveli i pages; H-74 314 eu bruto
- Periudha e kontrates;12 muaj me mundësi vazhdimi
- Oret e punes;40 orë në javë
- Pergjegjës-mbikqyrës ;Drejtori i QKMF

Kushtet për punëtor teknik-pastrues :

- Të jenë shtetas/e të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të kryer shkollën fillore ;
- Të jetë një entuziast dhe i /e aftë për të punuar;
- Të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efektive në një ambient multi-etnik ;

Detyrat dhe përgjegjësit

Të bëjë pastrimin dhe të mirëmbajë higjienën mbrenda objektit të QKMF-së dhe jashtë objektit;

- Të bëjë menagjimin e mbetjeve medicinale dhe djegëjen e tyre në inserator , pastrimin e objektit si dhe pastrimin e oborrit të objektit të QKMF-së
- Kryerja e detyrave tjera sipas udhëzimit të mbikqyrësit;
- Aplikacionet merren në zyrën e Personelit nr.9 -K.Dragash;
- Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet;
- Letërnjoftimi, ekstrakti i lindjes, diploma fotokopje e vërtetuara te noteri,vertetimi për përvojen e punes;
- Dokumentet e pa kompletuara nuk merren në shqyrtim;
- Afati i konkurimit **është 15 ditë** nga dita e publikimit në gazetë;

Vërejtje;Kandidatët të cilet konkurojnë për këtë pozitë duhet të jenë qytetar të integruar në institucionet e Republikës së Kosovës.

Shërbimi i Personelit
Dragash



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Komuna Dragash/ Opštine Dragaš / Daragas Municipality

Dt.19/06/2020

Në bazë të nenit 8 paragrafi 1. Dhe 2. të Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës Nr.03/L-212, kërkesës së drejtorit për Administrat K. Dragash me nr.02.111/01-7630/20 dt.04/06/2020,aprovimit nga kryetari i Komunes së Dragash-it Shërbimi I Personelit K.Dragash shpallë:

KONKURS

- Vendi i Punës; Punëtor teknik-Pastrues në objektin e K.Dragash
- Niveli i pages; K 4
- Periudha e kontrates;12 muaj me mundësi vazhdimi
- Oret e punes;40 ore në javë
- Pergjegjës-mbikqyrës ;Drejtori për Administrat

Kushtet për punëtor teknik-pastrues :

- Të jenë shtetas/e të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të kryer shkollën fillore ;
- Të jetë një entuziast dhe i /e aftë për të punuar;
- Të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efektive në një ambient multi-etnik ;

Detyrat dhe përgjegjësit

- Të bëjë pastrimin dhe të mirëmbajë higjienën mbrenda objektit;
- Kryerja e detyrave tjera sipas udhëzimit të mbikqyrësit;
- Aplikacionet merren në zyrën e Personelit -K.Dragash nr 9;
- Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet;
- Letërnjoftimi, ekstrakti i lindjes, diploma fotokopje e vërtetuara te noteri,vertetimi për përvojen e punes;
- Dokumentet e pa kompletuara nuk merren në shqyrtim;
- Afati i konkurimit **është 15 ditë** nga dita e publikimit në gazetë;

Shërbimi i Personelit
Dragash



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Komunal Dragash/ Opštine Dragaš / Dragas Municipality

Dt.19/06/2020

U skladu sa članom 8 stav 1. i 2. Zakona o Radu Republike Kosova br. 03 / L-212, zahtev direktora GCPM-a O. Dragaš br. 02.112 / 03-6226 / 20 dana 13 / 05/2020, odobreno od strane predsednika Opštine Dragaša, Kadrovska služba objavljuje:

KONKURS

(za zajednice)

- Radno mesto: Tehnički radnik-Čistač objekta GCPM-a, CPM-a i APM-a O.Dragaš
- Radno mesto: Tehnički radnik-Čistač objekta CPM-a Krusevo O.Dragas
- Nivo plate: H-74 314 eura bruto
- Period ugovora: 12 meseci sa mogućnošću produženja
- Radni sati: 40 sati nedeljno
- Nadležno lice: Direktor GCPM-a

Uslovi tehničkog osoblja-čistač:

- Da bude državljanin Republike Kosova;
- Da ima završenu osnovnu školu;
- Da bude entuzijasta i sposoban za rad;
- Da ima sposobnost efikasnog rada u multietničkom okruženju;

Dužnosti i odgovornosti.

- Da čisti i održava higijenu unutar i izvan objekta GCPM-a;
- Da upravlja medicinskim otpadom i spalivanje u inseratoru, čišćenje objekta i čišćenje dvorišta GCPM-a;
- Da izvršava druge dužnosti prema nalogu nadzornika;
- Aplikacije se uzimaju u kancelariji Kadrovske službe br.9 -O.Dragas.
- Aplikaciji se prilažu dokumenti: lična karta, ekstrakt rođenih, fotokopija diploma sertifikovana od strane notara, potvrda o radnom iskustvu.
- Nepotpuna dokumentacija se neće razmatrati.
- Rok za konkurs je **15 dana** od dana objavljivanja u novinama.
- Napomena:** Kandidati koji konkurisu za ovu poziciju trebaju biti integrisani građani u institucijama Republike Kosova.

Kadrovska služba O.Dragas



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Komuna Dragash/ Opštine Dragaš / Daragas Municipality

Dt.19/06/2020

U skladu sa članom 8 stav 1. i 2. Zakona o Radu Republike Kosova br. 03 / L-212, zahtev direktora administracije O. Dragaš br. 02.111 /01-7630/20,dt.04/06/2020, odobreno od strane predsednika Opštine Dragaša, Kadrovska služba objavljuje:

KONKURS

- Radno mesto: Tehnički radnik-Čistač objekta O.Dragaš
- Nivo plate: K 4
- Period ugovora: 12 meseci sa mogućnošću produženja
- Radni sati: 40 sati nedeljno
- Nadležno lice: Direktor Administracije

Uslovi tehničkog osoblja-čistač:

- Da budete državljanin Republike Kosova;
- Da ima završenu osnovnu školu;
- Da budete sposobni za rad;
- Da ima sposobnost efikasnog rada u multietničkom okruženju;

Dužnosti i odgovornosti.

- Da čisti i održava higijenu unutar objekta;
- Da izvršava druge dužnosti prema nalogu nadzornika;
- Aplikacije se uzimaju u kancelariji Kadrovske službe -O.Dragas.
- Aplikaciji se prilažu dokumenti: lična karta, ekstrakt rođenih, fotokopija diploma sertifikovana od strane notara, potvrda o radnom iskustvu.
- Nepotpuna dokumentacija se neće razmatrati.
- Rok za konkurs je **15 dana** od dana objavljivanja u novinama.

Kadrovska služba O.Dragas

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Po International" L.L.C. Greme, Ferizaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Fabrikën për prodhimin e lëngjeve freskuese me bazë të frutave dhe me gaz CO₂ në Greme, Ferizaj.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 10.07.2020 në ora 11:00 në objektet e kompanisë "Po International" L.L.C. Greme, Ferizajne zyret e fabrikes e cila gjendet ne zonenkadastrale te fshatit Greme edhe ate ne periferi te fshatitdo të organizohet debat publik nga kompania "Po International" L.L.C. Greme, Ferizaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Fabrikën për prodhimin e lëngjeve freskuese me bazë të frutave dhe me gaz CO₂ në Greme, Ferizaj.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejta

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► "Imer Abazi B.I." shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810052142

► Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardani. Banesa është 50 m², e mobiluar në tersi dhe është e gatshme për banim. Banesa preferohet për qift familjar. Tel: 044-171-328.

► Jap banesë me qira afër 60 m², kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m², me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m² dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m², kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m². Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m², dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

► Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shihni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

PASHTETË PULË

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues